

Gjykata e Qarkut ne Prishtine

P nr. 425/11

21.03.2012

Trupi Gjykses i Shqyrtimit Kryesor i përbëre nga Gjyqtaret e EULEX-it, Gjyqtari Jonathan Welford-Carroll, Kryetar i Trupit Gjykses, Gjyqtarja Shqipe Qerimi dhe Gjyqtari i EULEX-it Dean Pineles, Anëtar te Trupit Gjykses, ne lenden penale kundër:

AK et al

Mbi mocionit te Mbrojtjes për te shpallur deklaratat dhe ditarët e AZ te papranueshme, te parashtruar pranë Gjykates nga Prokuroria dhe qe përfshinë deklaratat dhe ditarët te shpallura si te pranueshme sipas Aktvendimit te Gjyqtarit te Konfirmimit te datës 26 gusht 2011,² dhe te percjellura pranë Trupit Gjykses për Shqyrtimin Kryesor se bashku me Aktakuzën dhe dëshmitë tjera;

Pas dëgjimit te argumenteve te Mbrojtjes ne seancat e Shqyrtimit Kryesor me 28 dhe 29 Shkurt 2012, 01, 06 dhe 07 Mars 2012, dhe pas shqyrtimit te argumenteve me shkrim te Avokatit Mbrojtjes Ramiz Krasniqi, te parashtruara pranë Gjykates me 12 Mars 2012;

Pas shqyrtimit te pergjegjes se Prokurorisë ndaj argumenteve te Mbrojtjes, te parashtruar me shkrim pranë Gjykates me 12 Mars 2012, dhe përgjigjen e Mbrojtjes te parashtruar me shkrim pranë Gjykates nga Avokati Mbrojtës Bajram Tmava dhe Mexhid Syla me 13 Mars 2012, Florin Vertopi edhe Xhafer Maliqi me 13 Mars 2012, Avokatja Mbrojtëse Fehmije Gashi-Bytyqi me 14 Mars 2012, Avokati Mbrojtës Karim A.A. Khan QC me 14 Mars 2012, Avokati Mbrojtës Qerim Zogaj me 14 Mars 2012, dhe Përgjigja e mëtutjeshme e Prokurorisë ne përgjigje te Avokatit Mbrojtës Karim A.A. Khan QC, e parashtruar pranë Gjykates me 15 Mars 2012;

Pas pleqnimit dhe votimit te mbajtur me 13 dhe 15 Mars 2012;

SIPAS Nenit 154 te Kodit te Procedurës Penale te Kosoves (KPPK);

lëshon këtë

**AKTVENDIM MBI PRANUESHMERINE
E DEKLARATAVE DHE DITAREVE TE AZ**

² Aktvendimi i Gjyqtarit te Konfirmimit te EULEX-it Ingo Risch, te datës 26.08.2011, para.VII, faqe.10, Dengu 2 i Gjykimit Gjyqësor 2

- I. **Deklaratat dhe ditarët e AZ, te parashtruara pranë Gjykates nga Prokuroria dhe e cila përfshinë deklaratat dhe ditarët e shpallura te pranueshme sipas Aktvendimit te Gjyqtarit te Konfirmimit, te datës 26 Gusht 2011, shpallen dëshmi te PAPANUESHME.**
- II. **Deklaratat dhe ditarët ne vijim te AZ do te përjashtohen nga dosja dhe do te mbyllen, dhe ato do te mbahen te ndara nga procesverbalet dhe dëshmitë tjera:**
- 1) Procesverbali i Policise se EULEX-it te Deklaratës se Dëshmitarit AZ me 20.11.2009, Dengu i Dosjes se PSRK M, PPS 07/10, Shtojca 1 e Raportit Policor te datës 11.12.2009.
 - 2) Procesverbali i Policise se EULEX-it te Deklaratës se Dëshmitarit AZ me 30.11.2009 dhe 3.12.2009, Dengu i Dosjes se PSRK M, PPS 07/10, Shtojca 2 e Raportit te Policise te datës 11.12.2009.
 - 3) Procesverbali i PSRK te Seancës mbi dëgjimin e te dyshuarit ne hetuesi, PPS 07/2010, te datës 04.02.2010, Dengu A i Dosjes se SPRK.
 - 4) Procesverbali i PSRK te Seancës mbi dëgjimin e te dyshuarit ne hetuesi, PPS 07/2010, te datës 09.02.2010, Dengu A i Dosjes se SPRK.
 - 5) Procesverbali i PSRK te Seancës mbi dëgjimin e te dyshuarit ne hetuesi, PPS 07/2010, te datës 11.02.2010, Dengu A i Dosjes se SPRK.
 - 6) Procesverbali i PSRK mbi dëgjimin e te Dyshuarit ne hetuesi, PPS 07/2010, te datës 16.02.2010, Dengu A i Dosjes se PSRK.
 - 7) Procesverbali i PSRK mbi dëgjimin e te Dyshuarit ne hetuesi, PPS 07/2010, te datës 17.02.2010, Dengu A i Dosjes se PSRK
 - 8) Procesverbali i PSRK mbi dëgjimin e te Dyshuarit ne hetuesi, PPS 07/2010, te datës 10.03.2010, Dengu A i Dosjes se PSRK
 - 9) Procesverbali i PSRK mbi dëgjimin e te Dyshuarit ne hetuesi, PPS 07/2010, te datës 16.03.2010, Dengu A i Dengut te Dosjes se PSRK
 - 10) Procesverbali i PSRK mbi dëgjimin e te Dyshuarit ne hetuesi, PPS 07/2010, te datës 25.03.2010, Dengu A i Dosjes se PSRK.
 - 11) Procesverbali i PSRK mbi dëgjimin e te Dyshuarit ne hetuesi, PPS 07/2010, te datës 09.06.2010, te Dengut A te Dosjes se PSRK.
 - 12) Procesverbali i PSRK mbi dëgjimin e te Dyshuarit ne hetuesi, PPS 07/2010, te datës 20.08.2010, Dengu A i Dosjes se PSRK.
 - 13) Procesverbali i PSRK mbi dëgjimin e te Dyshuarit ne hetuesi, PPS 07/2010, te datës 05.10.2010, Dengu A i Dosjes se PSRK.
 - 14) EULEX/WCIU Tabela Fotografike e Raportit te Procedurës Identifikuese te datës 07.10.2010, Dengu A i Dosjes se PSRK.
 - 15) Procesverbali i PSRK i dëgjimit te Dëshmitarit Bashkëpunues ne hetuesi, PPS 07/10, te datës 05.07.2011, Dengu A/bis i Dosjes se PSRK.
 - 16) Procesverbali i PSRK i dëgjimit te Dëshmitarit Bashkëpunues ne hetuesi, PPS 07/10, , te datës 06.07.2011, Dengu A/bis i Dosjes se PSRK.

- 17) Procesverbali i PSRK i dëgjimit të Dëshmitarit Bashkëpunues në hetuesi, PPS 07/10, të datës 07.07.2011, Dengu A/bis i Dosjes së PSRK
- 18) Procesverbali i PSRK i dëgjimit të Dëshmitarit Bashkëpunues në hetuesi, PPS 07/10, , të datës 09.07.2011, Dengu A/bis i Dosjes së PSRK.
- 19) Dëshmitë që përmbajnë të ashtuquajturit 'ditarë të luftës', të shënuara si: 0096-09-EWC2/008, 0096-09-EWC2/009, 0096-09-EWC2/010, 0096-09-EWC2/011, 0096-09-EWC2/012, 0096-09-EWC2/013, 0096-09-EWC2/014, 0096-09-EWC2/015, 0096-09-EWC2/016.³
- 20) Dëshmitë që përbejnë të ashtuquajturit 'ditarë të pas luftës', të shënuar si: 0096-09-EWC2/001, 0096-09-EWC2/002, 0096-09-EWC2/003, 0096-09-EWC2/004, 0096-09-EWC2/005, 0096-09-EWC2/006, 0096-09-EWC2/017, 0096-09-EWC2/018.
- 21) Dëshmitë që përbejnë të ashtuquajturit 'Ditarët Gjerman', të parashtruar nga PSRK në seancën e shqyrtimit kryesor më 11.11.2011, të shënuar nga Gjykata si Prova P1(b).

ARSYETIM

A. KONSIDERATAT PRELIMINARE

1. Në këtë lende, secila ekipë e Mbrojtjes e ka kundërshtuar pranueshmërinë e deklaratave të AZ (dëshmitarit X) dhe ditareve të tij shoqërues në baza të shumëfishta.⁴ Prokuroria qëndron mbi të se materialet e tilla janë të pranueshme si duhet dhe duhet të ruhet për Shqyrtimin Kryesor kundër *AK dhe të tjerëve* (të njohur si rasti Kleçka).
2. Që nga fillimi, shënimet dhe procesverbalet e Trupit Gjykses se rrethanat në këtë lende, si dhe vendimi që Trupi Gjykses duhet ta marrë tani për qeshtjen e pranueshmërisë, janë të shume të pazakonshme, të veçanta dhe mundësisht edhe unike. Tërësia e lendes së Prokurorisë bie mbi një dëshmitar, AZ, i cili ka qenë bashkë-kryes i veprës penale së bashku me të pandehurit e akuzuar në sjelljen e pretenduar. Aktakuza PPS no.07/2010 e Prokurorit Special të EULEX-it thotë: 'në rastin e menjëhershëm, dyshimi i fortë i bazuar

³ Duhet të ceket se disa pjesë apo të gjitha dokumentet të shënuara 0096-09-EWC2/009, 0096-09-EWC2/010, 0096-09-EWC2/015 dhe 0096-09-EWC2/016 nuk përfshijnë data për se për atë se kur pretendimet se janë shkuar (p.sh. në pjesën e epërme të faqes si në raste tjera) por disa nga ato i referohen datave dhe/apo ngjarjeve në vitin 1998, 1999 dhe esencialisht janë në të njëjtin format si të ashtuquajturit 'ditarët e luftës' (këto janë copa të letrës të shkruara me emra të ndryshëm) Për këtë arsye Gjykata i ka konsideruar ato si pjesë e të ashtuquajturve 'ditere e luftës'.

⁴Prezantimi i argumenteve mbi pranueshmërinë e deklaratave dhe ditareve të AZ ka filluar më 28 Shkurt 2012. Në seancat e Shqyrtimit Kryesor nga data 28 Shkurt 2012 deri më 07 Mars 2012 Mbrojtja i ka prezantuar argumentet e tyre. Kundërshtimet për pranueshmërinë e deklaratave dhe ditareve të AZ vetëm ishte ngritur nga Mbrojtja në parashtrësitë e mëparshme me shkrim si dhe gjatë seancave të mëparshme, duke përfshirë edhe seancën e 30 Janarit 2012 dhe 07 Shkurt 2012.

kundër të gjithë të pandehurve rrjedh me se shumti nga deklaratat e dëshmitarit bashkëpunues X, me pare i dyshuar Brenda të njëjtit hetim.’⁵ Me tutje , në seancën e 30 Janar 2012, Prokurori Special në kontekst të dëshmisë së AZ ka vërejtur se: ‘Qeshtja e pranueshmerisë është i paraprindës asaj, përndryshe nuk ka Shqyrtim Kryesor.’⁶

3. AZ i ka pasur disa lloje të statusit, të dëshmitarit në lende dhe të dëshmitarit bashkëpunues dhe ai ka vdekur për Shqyrtim Kryesor. Prandaj, ai nuk është me në dispozicion për tu marrë në pyetje për Trupit Gjykes. Shumica, nëse jo të gjitha, nga këto vështësi nuk do të ekzistojnë nëse AZ do të ishte gjallë për të dhënë dëshmi në Shqyrtim Kryesor. Është tragjike për atë, për familjen e tij dhe për këtë lende që ai nuk është i gjallë.
4. Vështësitë e krijuara nga ky grup i veçantë i rrethanave bëhen edhe më të mëdha me faktin se tërësia e përcaktimit final të Trupit Gjykes të lendes bie mbi vlerësimin në detaje të besueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së AZ (duke supozuar se deklaratat dhe ditaret e tij në fakt janë pranuar) duke pasur parasysh gjithashtu edhe ndikimin e KPPK, Nenin 157(4) se ‘gjykata nuk do të shpallë asnjë person fajtor vetëm në dëshminë e dëshmitarit të dhënë nga dëshmitarit bashkëpunues’. Edhe pse dosja e lendes tregon material që vërteton tregimin e AZ për të se çka ka ndodhur në Kleçke, nuk ekziston asnjë material që vërteton pohimin e AZ për të identifikuar atë se kush e ka bërë atë. Një shqyrtim në detaje të lendeve të vendosura në Kosovë dhe në Tribunalet Ndërkombëtare duke përfshirë Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut tregojnë rrethanat e këtij rasti të janë gati unike.
5. Materialet e sfiduara janë treguar me lart në paragrafin II të Dispozitivit të këtij Aktvendimi dhe nuk janë përsëritur.

B. HISTORIA FAKTIKE DHE PROCEDURALE

a) Rrethanat faktike të lendes

6. Është e domosdoshme të sqarohen në detaje të veçanta rrethanat faktike në këtë lende. AZ ka qenë anëtar i UCK-se. Ai iu është bashkangjitur UCK-se rreth Prillit 1998 (me nofke të luftës ‘MZ’). Shumë shpejt ai është takuar dhe të njëjtit të pandehurit në këtë lende, duke përfshirë edhe FL. Sipas AZ, FL ka qenë komandant i zonës duke përfshirë Kleçkën. Në Kleçke, një shtëpi është shendërruar në lokale të UCK-se, e përshkruar në mënyrë të ndryshme si Shtabi Kryesor, në stacion policor ushtarak dhe në kamp paraburgimi.

⁵ Aktakuza PPS no.07/2010, faqe.16 (në versionin Anglisht) Dengu 1 i Dosjes së Lendes

⁶ Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 30 Janar 2012, par..76, 101, 103, 105, Dengu 6 i Lendes së Gjykimit

7. AZ thotë se FL e ka bere atë kujdestar te burgosurve ne Kleçke. Edhe pse ai nuk e pranon se ai ka pasur komandim te teresishem te qendrës se paraburgimit, ne kohe AZ duket se ka marre pergjegjesine e udhëheqjeve ditore te qendrës. Ne shume deklarata AZ tregon për ngjarjet ne Kleçke te cilat ai i kishte pare dhe ne te cilat ai kishte marre pjese. Këto ngjarje, nëse te vërteta, padyshim kane mundësinë e arritjes se nivelit te Krimeve te Luftës.
8. Gjate tere periudhës se tij ne shërbim te UCK-se AZ pohon se ai ka mbajtur ditar. Te dhënat ne atë ditar thuhet se janë bere gjerësisht njëkohësisht me ngjarjet e përshkuara nga vete AZ. Ai mohon se te tjerët janë pergjegjes për ato te dhëna. Shprehia e mbajtjes se ditarit edhe pas luftës edhet mbajtur si dëshmi nga ditarët e pas luftës. AZ pohon se ai i ka ruajtur dhe i ka fshehur ditarët e tij te luftës qe nga fundi I luftës e gjer ne kohen kur ai ia ka dorëzuar ato policisë.
9. Pas luftës, duket se marredhenja ndërmjet AZ dhe FL dhe shokëve te tij janë prishur, veçanërisht pasi qe eshte dukur e qarte se AZ ishte bere dëshmitar ne hetimin e Tribunalet Ndërkombëtar te Krimeve për ish-Jugosllavi kundër FL. AZ i ka dhëne deklarata hetueseve ne Tribunal Ndërkombëtar te Krimeve për ish-Jugosllavi ne vitin 2004. Ne atë rast, AZ nuk ka dhëne dëshmi para TNK për ish-Jugosllavi.

b) AZ ne cilësinë e dëshmitarit

10. Dikur ne korrik 2009, AZ ne mënyre vullnetare iu eshte paraqitur Njësisë për Krime te Luftës pranë.⁷ Me 20 dhe 30 Nëntor dhe 03 Dhjetor 2009, AZ ka dhëne dëshmi hetueseve te Njësisë Hetuese për Krime te Luftës te EULEX-it. Ne ato raste ai e ka pasur statusin e dëshmitarit.
11. KPPK, Neni 164(2) dhe Neni 162 kërkojnë qe vërejtjet ne vijim ti jepen dëshmitarit para marrjes se deklaratës se tij/saj: eshte obligimi i dëshmitarit te tregoje te vërtetën; dhe se ai apo ajo nuk m und te mbajnë asgjë te fshehte; se dëshmia e rrejshme shkakton vepër penale; por se ai nuk ka nevojte te përgjigjet ne pyetje te caktuara me te cilat ai mund te ekspozoje veten apo ndonjë te afërm para turpi te rende, demi te konsiderueshme material apo ndjekje penale. Këto vërejtje janë dhëne nga ana e hetueseve te EULEX-it.

c) AZ ne cilësinë e te pandehurit

⁷ Procesverbali i PSRK mbi dëgjimin e te dyshuarit ne hetime, te datës 16 Mars 2010, faqe 4 (versioni Anglisht) Dengu A i Lendes se PSRK.

12. Prokurori e ka lëshuar urdherin mbi fillimin e hetuesisë ndaj AZ dhe pretendimet e tij te 02 Shkurt 2010 sipas KPPK, neni 221.
13. Me 04, 09, 11, 16, 17 Shkurt 2010, me 10, 16, 25 Mars 2010, dhe 09 Qershor 2010, dhe 20 Gusht 2010, AZ është intervistuar rreth pretendimeve të tij nga Prokurori.⁸ Transkriptet mbajnë titullin 'procesverbal i dëgjimit të dyshuarit në hetime'. KPPK 151(1) e definon 'te dyshuarin' si 'person për të cilin policia apo autoritet w ndjekjes penale kanë dyshim të arsyeshëm se ka kryer veprë penale por që **nuk kanë** filluar procedurat penale kundër tij'. Meqë procedurat kundër AZ kanë filluar me Aktvendimin mbi fillimin e hetimeve, të lëshuar nga Prokurori Special i EULEX-it me 02 Shkurt 2010, gjatë intervistës në fjalë në Shkurt, Mars, Qershor dhe Gusht 2010, AZ e ka pasur statusin e të pandehurit, sipas nenit 151 (2) të KPPK.
14. Neni 231(2) i KPPK thotë se para qfaredo marrje në pyetje i pandehuri do të njoftohet për të drejtat në vijim; për akuzat kundër tij/saj, të drejtën e heshtjes; të drejtën për përkthyes; të drejtën për avokat mbrojtës; për faktin se deklaratat e tij mund të përdoren si dëshmi para gjykatës dhe për faktin se ai mund të kërkojë që dëshmia të përdoret për mbrojtjen e tij/saj. Neni 231(2) i KPPK e përmban termin 'do të' prandaj përmban udhëzime obliguese të cilat duhet ti jepen të pandehurit para marrjes në pyetje. Me tutje, Neni 235 i KPPK në mënyrë eksplicite përshkruan se nëse marrja në pyetje e të pandehurit është kryer në shkelje të dispozitës, deklaratat e të pandehurit do të jete e papranueshme.
15. Transkriptet e secilës nga intervistat e datave të lartshënuara të muajve Shkurt, Mars, Qershor dhe Gusht 2010 tregojnë se AZ është informuar për të drejtat e tij sipas Nenit 23(2) të KPPK'. Trupi Gjykses supozon se ky është një gabim dhe se transkripti ka pasur për qëllim të referohet Nenit 231(2) të KPPK. Sipas atij Neni, Prokurori Special e ka informuar AZ për; akuzat kundër tij; se ai ka pasur të drejtë në heshtjes; se ka pasur të drejtën e përkthyesit dhe se ka pasur të drejtën për avokat mbrojtës. Edhe pse Transkriptet e datave 04 dhe 11 Shkurt 2010 në disponim të trupit Gjykses nuk regjistrojnë nënshkrimin e AZ për heqje dore nga ana e tij. (Për këtë shiko me shume në paragrafët 83-86 me poshtë)
16. Në intervistat e datave të lartshënuara në Shkurt, Mars, Qershor dhe Gusht 2010, Prokurori **nuk e ka** informuar AZ se deklaratat e tij mund të përdoren si dëshmi para Gjykses dhe se ai ka pasur të drejtë të kërkojë që dëshmia të përdoret në mbrojtje të tij. Kjo përbenë shkelje të kushteve obliguese të KPPK, Neni .231(2)5) dhe 6). (shiko me poshtë par. 87.)

⁸ Procesverbalet mbahen në Dengun A të PSRK

17. Tri intervistat e para me 04, 09 dhe 11 Shkurt 2010, esencialisht eshte përbëre nga citate te deklaratave te tij te dhëna hetueseve te EULEX-it. AZ ka vërtetuar çka kishte thënë me pare dhe ai ka bere disa shtesa dhe korrigjime dhe e ka bere rrëfimin për një krim shtese (për vrasjen e dy te burgosurve Serb)
18. Nga intervistat e 16 Shkurt 2010 e tutje, AZ ka filluar te diskutoje historinë e marredhenjes se tij me FL, gjithashtu duke e paraqitur besimin e tij se FL ka qene i përcaktuar te heshte AZ me qfaredo mjete te nevojshme.

d) AZ ne cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues

19. Pas dëgjimit personal te AZ, me 25 Gusht 2010, Gjyqtari i Procedurës Paraprake e ka shpallur AZ si dëshmitar bashkëpunues.
20. Prokurori Special e ka intervistuar AZ ne cilësinë e tij te re me 05 dhe 07 Tetor 2010. Duhet te ceket se AZ nuk eshte pyetur te vërtetoje deklaratat te cilat i kishte dhëne me pare ne cilësinë e te pandehurit (shiko par. 65-72 me poshtë). Intervistat e Tetorit 2010 ne lidhje me marrjen ne pyetje për disa dokumente dhe identifikime.

C. MARRJA NE PYETJE E AZ SIPAS NENIT 156(2) TE KPPK NDERMJET 05 DHE 09 KORRIK 2011 - 'MUNDESIA PER TE SFIDUAR'

a) Mungesa e AZ

21. Sipas autoriteteve te Republikës Federale te Gjermanisë, AZ eshte gjetur i vdekur. Data e vdekjes se tij eshte regjistruar 28 Shtator 2011 dhe shkak i vdekjes se tij si vetëvrasje me varje.
22. Prandaj AZ nuk eshte dëshmitar ne dispozicion për Shqyrtimin Kryesor.
23. Mbrojtja e ka sfiduar pranueshmerine e dëshmisë se deklaratave te tij te dhëna hetueseve dhe Prokurorit Special si dhe pranueshmerine e ditarëve te tij.

b) E Drejta e mbrojtjes ne sfidimit e Dëshmitarit

24. Neni 156(2) i KPPK thotë se 'deklarata e dëshmitarit e dhëne policisë apo prokurorit publik **mund te** jete dëshmi e pranueshme ne Gjykate vetëm kur te pandehurit apo avokatit mbrojtës iu eshte dhëne mundësia te sfidoje atë duke e marre ne pyetje dëshmitarin gjate ndonjë faze te procedurës penale'.

25. E drejta e mbrojtjes për të konfrontuar dëshmitarin/ta akuzuarin është përcaktuar mire në ligjin zakonor ashtu edhe në sisteme të ligjit civil. Te akuzuarit duhet të jepet mundësia të testojë me marrje në pyetje dëshmitë e kundërthënëse të dëshmitarit. Marrja në pyetje është paraqitur në Nenin Art.31(4) të Kushtetutës së Kosovës, duke treguar se kushdo që është i akuzuar me vepër penale ka të drejtë të marrë në pyetje dëshmitaret dhe të kërkojë paraqitjen e obliguese të dëshmitareve, eksperteve dhe personave tjerë të cilët mund të qartësojnë dëshminë. Neqoftese të pandehurit i mohohet ajo e drejtë, pa marrë parasysh se a është me qëllim ose tërësisht në mënyrë të pafajshme, në shumicën e sistemeve juridike penale një dëshmi e tillë ka gjasa shumë të vogla të kalojë para Trupit Gjyqësor në mungesë të mbrojtjeve të detajizuara procedurale për të siguruar drejtësi në shqyrtimin kryesor në tërësi, dhe brenda KPPK është subjekt i ndalesës absolute të Nenit 156(2) të KPPK.
26. E drejta e Mbrojtjes për të sfiduar dëshmitarin gjithashtu është e garantuar me nenin 6(3)(d) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtave themelore (ECHR). Është e drejtë themelore dhe një bazë kryesore për gjykim të drejtë. KE për të drejtë të Njeriut dhe të drejtat themelore ka konfirmuar se ‘e tërë dëshmia normalisht duhet të tregohet në prezencë të akuzuarit në seance publike me pikëpamje ndaj argumentit kundërthënëse.⁹ Në lidhje me këtë, neni 156(2) i KPPK krijon **përijashtime** së dëshmia e marrë jashtë gjykatës mund të tregohet në rrethana të specifikuar.
27. Neni.22 i Kushtetutës së Kosovës e bënë ECHR drejtpërdrejtë të aplikueshëm në sistemin vendor ligjor të Kosovës. Me tutje, neni 53 i Kushtetutës së Kosovës kërkon që ‘të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantohen me Kushtetute interpretohen në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECtHR). Prandaj, Trupi Gjyqësor duhet të interpretojë nenin Art. 156(2) të KPPK si ‘mundësi për të sfiduar’ në harmoni me konkludimet e Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë themelore të njeriut.
28. Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë themelore të njeriut (ECtHR) ka vëzhguar se mundësia për të sfiduar dhe për të marrë në pyetje dëshmitarin duhet të jepet të akuzuarit ‘ose në kohën kur dëshmitari është duke e dhënë deklaratën ose një fazë me të vonshme

⁹ Birutis dhe të tjerët v. Lituania, Aktgjykimi i 28 Mars 2002., ECtHR, para.28, <http://cmiskp.echr.coe.int/tkp197/view.asp?item=1&portal=hbkm&action=html&highlight=Birutis&sessionid=88607244&skin=hudoc-en>; Visser v. the Holanda, Aktgjykimi i datës 14 shkurt 2002, ECtHR, para.51, <http://cmiskp.echr.coe.int/tkp197/view.asp?item=1&portal=hbkm&action=html&highlight=Visser&sessionid=88603649&skin=hudoc-en>

te procedurave". Mirëpo, pjesa kryesore e përcaktimit të ECtHR është se një mundësi e tillë duhet të jetë **'adekuate dhe e duhur'**.¹⁰

29. Nëse, duke i marre parasysh të gjitha rrethanat, mundësia për të sfiduar AZ nga Mbrojtja nuk është 'adekuate dhe si duhet' atëherë kjo nuk është fare mundësi dhe kushti precedent obligues i Nenit 156(2) të KPPK nuk është plotësuar.
30. Kundër kësaj historie, Trupi Gjykesor ka konsideruar të gjitha rrethanat në të cilat Mbrojtjes iu është dhënë mundësia të sfidojë akuzat e AZ, dhe se a ka qene ajo mundësi **'adekuate dhe e duhur'**.

c) Rrethanat e Mundësisë për të Sfiduar AZ

31. Me 05, 06, 07 dhe 09 Korrik 2011, një seri e intervistave të AZ kanë ndodhur me nxitjen e Prokurorit në të cilat Avokatet Mbrojtës të gjithë të pandehurve dhe vetë disa të pandehur kanë marrë pjesë. Mbrojtja është ftuar të marrë pjesë në këto seanca sipas dokumentit të titulluar 'Ftesa për hetim në procedurë paraprake' të datës 27 Qershor 2011, të tërë ditë para fillimit të seancave. Qëllimi i cekur i këtyre seancave ka qene për të dhënë Mbrojtjes 'mundësinë për të sfiduar deklaratat e dëshmitarit AZ duke e marrë atë në pyetje'.¹¹ Prandaj dokumenti i ka miratuar shprehjet e Nenit 156(2) të KPPK.
32. Edhe pse Mbrojtja ka marrë pjesë dhe deri në disa shkallë ka marrë pjesë në proces, në të njëjtën kohë Trupi Gjykesor vëzhgon se kundërshtimet e shumta dhe kritikën janë futurë në procesverbal. Këto përfshihen por nuk janë të kufizuara në:
 - 1) Mos denja e mjaftueshme e dokumenteve Mbrojtjes nga Prokuroria para intervistave.¹²
 - 2) Qe qëllimi i seancave nuk është bërë i qartë Mbrojtjes¹³ dhe nëse ka qene qëllimi për t'u përmbajtur kërkesave të Nenit 156(2) të KPPK mbrojtja nuk ka qene e gatshme.¹⁴

¹⁰ *Kostovski v. the Netherlands*, Aktgjykimi i 20 Nëntor 1989, ECtHR, para.42, <http://cmiskp.echr.coe.int/tkp197/view.asp?item=1&portal=hbkm&action=html&highlight=Kostovski&sessionid=88606816&skin=hudoc-en>; *Birutis dhe të tjerët v. Lithuania* Aktgjykimi i datës 28 Mars 2002, ECtHR, para.28, <http://cmiskp.echr.coe.int/tkp197/view.asp?item=1&portal=hbkm&action=html&highlight=Birutis&sessionid=88607244&skin=hudoc-en>; *Visser v. the Netherlands*, Aktgjykimi i 14 Shkurt 2002, ECtHR, para.51, <http://cmiskp.echr.coe.int/tkp197/view.asp?item=1&portal=hbkm&action=html&highlight=Visser&sessionid=88603649&skin=hudoc-en>

¹¹ Ftesa e PSRK për hetim para procedurës paraprake, PPS 07/10, të datës 27 Qershor 2011, shtojca në procesverbalin e shqyrtimit kryesor 07 Mars 2012, Dengu i Shqyrtimit Kryesor 8, pjesa 26

¹² Procesverbali i PSRK të Seancës së dëgjimit të dëshmitarit bashkëpunues në hetuesi, PPS 07/10, të datës 05 Korrik 2011, faqet.2, 5, Dengu i PSRK a/bis.

¹³ Procesverbali i PRSK mbi dëgjimit të Dëshmitarit Bashkëpunues në hetuesi PPS 07/10, të datës 05 Korrik 2011, fq.3, Dengu A/bis i PRSK. Në lidhje me kërkesën për të dhënat Prokurori Special përgjigjet: '...nuk e dimë nëse do të kemi shqyrtim kryesor. Nëse do të kemi shqyrtim kryesor në do të përmbahemi afatit kohor'

- 3) Qe qëllimi i marrjes ne pyetje sipas nenit 156(2) te KPPK nuk ka qene i ligjshëm prandaj një Avokat Mbrojtës ka refuzuar te marre pjese¹⁵
 - 4) Qe séance e propozuar nuk eshte dashur te behet sipas nenit 156 te KPPK para prokurorit por sipas nenit .238 te KPPK para Gjyqtarit te Procedurës Paraprake.¹⁶
 - 5) Qe Prokuroria ka qene e obliguar te ri-dëgjoje AZ si dëshmitar bashkëpunues sepse deklaratat e mëparshme janë marre nga ia ne cilësinë e te pandehurit¹⁷
 - 6) Qe Prokuroria eshte dashur se pari te marre ne pyetje AZ ne prezence te Avokatit Mbrojtës dhe pyetjet nga Avokati Mbrojtës pastaj duhet te vijojnë.¹⁸
 - 7) Qe Mbrojtja e kupton qëllimin qe seancës e propozuar eshte për te ndihmuar Prokurorinë te plotësoje obligimet e saj statutare për te gjetur te vërtetën dhe marrja ne pyetje e Mbrojtjes nuk do te jete e kufizuar ne te funksion, qe marrja e plote ne pyetje gjate shqyrtimit kryesor do te merrte tri jave e jo dite te afuara nga Prokuroria ne ftesën e saj, kështu qe marrja ne pyetje eshte ‘e fokusuar deri ne atë fund’ dhe ne ‘pika te reja te fokusuara’.¹⁹
33. Siç eshte treguar me lart, ne rrethana te caktuara, sipas Nenit 156(2) te4 KPPK,marrja ne pyetje ne ‘një faze te caktuar te procedurave penale’ mund te jete e mjaftuar te merren te pranueshme deklaratat e dëshmitarit jashtë gjykimit gjate Shqyrtimit Kryesor.
34. Gjersa, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut dhe te Drejtave themelore (ECHR), sa i përket pranueshmerise se dëshmisë, ne raste te ndryshme k a përsëritur se ‘pranueshmeria e dëshmisë ne mënyre primare qeveriset nga rregullat e ligjit vendor, dhe si rregull, varet nga gjykatat kombëtare te vlerësojnë dëshminë para tyre’, eshte theksuar se te drejtat e mbrojtjes duhet te respektohen dhe ‘te pandehurit

¹⁴ Procesverbali i PRSK mbi dëgjimin e dëshmitarit bashkëpunues ne hetime PPS 07/10, te datës 05 Korrik 2011, fq3, Dengu A/bis i PRSK. Avokati Mbrojtës Bajram Tmava thotë : ‘nëse dëshirojmë ti përmbushim kërkesave te nenit 156 te KPPK unë nuk jam gati sot te largohem nga funksioni im si avokat mbrojtës.’ Gjithashtu, procesverbali i PRSK mbi Dëgjimin e dëshmitarit bashkëpunues ne hetime PPS 07/10, te datës 06 Korrik 2011, fq.13, Dengu A/bis i PSRK.

¹⁵ Procesverbali i PRSK mbi dëgjimin e dëshmitarit bashkëpunues ne hetime PPS 07/10, te datës 06 Korrik 2011, fq.13, Dengu A/bis i PSRK.

¹⁶ Procesverbali i PRSK mbi dëgjimin e dëshmitarit bashkëpunues ne hetime PPS 07/10, te datës 05 Korrik 2011, fq.3, 4, S, Dengu A/bis i PSRK.

¹⁷ Procesverbali i PRSK mbi dëgjimin e dëshmitarit bashkëpunues ne hetime PPS 07/10, te datës 05 Korrik 2011, fq4, Dengu A/bis i PSRK

¹⁸ Procesverbali i PRSK mbi dëgjimin e dëshmitarit bashkëpunues ne hetime PPS 07/10, te datës 05 Korrik 2011, fq. 5, Dengu A/bis i PSRK

¹⁹ Procesverbali i PRSK mbi dëgjimin e dëshmitarit bashkëpunues ne hetime PPS 07/10, te datës 07 Korrik 2011, fq. 2, Dengu A/bis i PSRK. Avokati Mbrojtës Karim A.A. Khan QC shënon: ‘Atëherë sot eshte mundësia për mua te shtroje pyetje te cilat me shprese do te ndihmojnë mbrojtje te heqë dore nga obligimet statusore për te gjetur te vërtetën . Kështu qe pyetjet qe I shtroj janë te fokusuara ne atë fund. Me tutje Avokati Mbrojtës Karim A.A. Khan QC thotë: ‘...nëse nuk shkon ne shqyrtim kryesor ndoshta unë do te kam nevojë për tri jave me ju, e jo tri dite nga sot. Kjo eshte arsyeja pse unë do te fokusohem ne disa pika te reja’

duhet ti jepet mundësi adekuate dhe e duhur te sfidoje dhe te marre ne pyetje dëshmitarin kundër tij .²⁰

35. Prandaj, 'mundësia për te sfiduar' ne nenin.156(2) te KPPK duhet te jete 'adekuate dhe e duhur '. Me fjale tjera, duhet te jete reale, duke e mundësuar mbrojtjen ne angazhimin substancial me dëshminë e dëshmitarit. Nuk eshte e mjaftueshme qe vetëm te përcjellët letra e ligjit. Njeriu duhet te këtë parasysht esencën dhe qëllimin e ligjit i cili eshte për te mbrojtur drejtësinë e shqyrtimit kryesor duke mbrojtur te drejtën e pa negociuar te pandehurit për te sfiduar te akuzuarin e tij/saj.
36. Gjykata duhet te këtë parasysht te gjitha rrethanat, duke përfshire por jo te jete e kufizuar ne: kohen e periudhës kohore te vërejtjes se dhëne për te lejuar kohe te duhur te përgatitjes; fazën e procedurave; Kompleksitetin e rastit; rendësin relative te dëshmitarit; Nivelin e te dhënave te dokumenteve te dhëna mbrojtjes apo materialin relevant i cili se paku duhet te përfshije qfaredo materiali qe e nënvlerëson rastin e Prokurorisë apo qe mund,ne mënyre te arsyeshme, te ndihmoje rastin e mbrojtjes; statusi i dëshmitarit, i dëshmitarit I cili ose eshte ose ka qene i akuzuar për te njëjtat vepra duhet te kërkojnë me shume kujdesi se sa dëshmitari i cili nuk eshte I implikuar ne shkelje te ligjit , e këtu duke eskaluar detyrën mbi Prokurorinë për te siguruar se janë dhëne dokumente adekuate dhe te drejta..

d) Gjendja e te dhënave nga Prokuroria

37. Sa i përket te dhënave nga Prokurori Special, nga përgjigjet e Prokurorit te dhëna Mbrojtjes ndaj argumenteve te tyre mbi pranueshmerine e AZ, te datës 12 Mars 2012, vijon se para 05 Korrik 2011 dokumentet ne vijim janë dhëne mbrojtjes.
38. **Dengu A**, i PSRK i cili përmban:
- 1) Deklarata e AZ te dhëna Prokurorit Special me 04 Shkurt 2010, pa shtojca..
 - 2) Deklarata e AZ te dhëna Prokurorit Special me 09 Shkurt 2010, me shtojcat:
Plani i skemës se burgut te Kleçkës;
Një faqe e datuar 15.03.99 nga 0096-09-EWC2/012.
 - 3) Deklarata e AZ te dhëna Prokurorit Special me 11 Shkurt 2010, me këto shtojca:
Një faqe e datuar 21.03.99 nga 0096-09-EWC2/012;
Një faqe e datuar 03.04.99 nga 0096-09-EWC2/012;

²⁰ Doorson v. the Netherlands, Aktgjykimi 26 Mars 1996, ECtHR, para.67, <http://cmiskp.echr.coe.int/tkp197/view.asp?item=1&portal=hbkm&action=html&highlight=Doorson&sessionid=88607244&skin=hudoc-en>; Al-Khawaja dhe Tahery v. Britania e Madhe, Aktgjykimi 15 Dhjetor 2011, ECtHR, para.118, <http://cmiskp.echr.coe.int/tkp197/view.asp?item=1&portal=hbkm&action=html&highlight=Al-Khawaja&sessionid=88607244&skin=hudoc-en>

Një faqe e datuar 03.04.00 nga 0096-09-EWC2/012;

Një faqe, n/d, nga 0096-09-EWC2/011.

- 4) Deklarata e AZ te dhëna Prokurorit Special me 16 shkurt 2010, pa shtojca
- 5) Deklarata e AZ te dhëna Prokurorit Special me 17 Shkurt 2010, pa shtojca.
- 6) Deklarata e AZ te dhëna Prokurorit Special me 10 Mars 2010, pa shtojca.
- 7) Deklarata e AZ te dhëna Prokurorit Special me 16 Mars 2010, me këto shtojca:
Annex 7, (fotografitë e vend zhvarrosjes dhe Kleçka);
Annex 8, fotografi e AZ ne uniforme te UCK-se .
- 8) Deklarata e AZ te dhëna Prokurorit Special me 25 Mars 2010, me shtojca:
Annex 9, deklarata e Policise se Kosoves te datës 16.07.2007.
- 9) Deklarata e AZ dhënë përpara Prokurorit Special me datë 09 qershor 2010, me pjesë të bashkangjitura:
Pjesë të ndryshme të bashkangjitura lidhur me indentifikimin e personave që njeh AZ.
- 10) Deklarata e AZ dhënë përpara Prokurorit Special me datë 20 gusht 2010, me pjesë të bashkangjitura:
Pjesë të ndryshme të bashkangjitura lidhur me indentifikimin e personave që njeh AZ.
- 11) Deklarata e AZ dhënë përpara Prokurorit Special me datë 05 tetor 2010, me pjesë të bashkangjitura:
Shtojca 1, një faqe e datës 06.05.99 nga 0096-09-EWC2/024 (raporti që tregon të burgosur që sillen brenda dhe jashtë gjatë periudhës kohore 20.02.99 - 06.05.99;
Shtojca 2, një faqe e datës 15.05.99 nga 0096-09-EWC2/032 (kërkesë për staf burgu shtesë);
Shtojca 3, një faqe e datës 15.05.99 nga 0096-09-EWC2/031 (kërkesë për deklaratë me shkrim mbi të drejtat dhe detyrat e personelit të burgut);
Shtojca 4, një faqe e datës 14.06.99 nga 0096-09-EWC2/028 (raporti i punës për periudhën kohore 06.05.99 - 14.06.99 për tre të burgosur);
Shtojca 5, një faqe e datës 15.06.99 nga 0096-09-EWC2/035 (kërkesë për roje burgu shtesë);
Shtojca 6, një faqe e datës 20.06.99 nga 0096-09-EWC2/029 (raport pune për periudhën kohore 14.06.99 - 20.06.99 për tre të burgosur);
Shtojca 7, një faqe e datës 22.06.99 nga 0096-09-EWC2/027 (raport pune i datës 20.06.99 – 22.06.99, në të cilin deklarohet se pas transferimit të burgut në Malishevë AZ ishte i detyruar të lirojë dy të burgosur);
Shtojca 8, një faqe e datës 02.02.99 nga 0096-09-EWC2/034 (urdhër nga gjyqtari ushtarak për të marrë dy të burgosur);
Shtojca 9, një faqe e datës 14.02.99 nga 0096-09-EWC2/023 (urdhër nga gjyqtari ushtarak për të marrë një të burgosur);

Shtojca 10, një faqe e datës 02.03.99 nga 0096-09-EWC2/022 (manual mbi implementimin e procedurës ndaj të burgosurve);

Shtojca 11, një faqe e datës 26.04.99 nga 0096-09-EWC2/030 (vendim i gjyqtarit ushtarak për të vendosur BSO në ndalim);

Shtojca 12, një faqe e datës 05.05.1999 nga 0096-09-EWC2/026 (aktgjykim për IHC);

Shtojca 13, një faqe e datës 17.05.1999 nga 0096-09-EWC2/025 (aktgjykim për dëshmitarin anonim B);

Shtojca 14, një faqe e datës 30.05.1999 nga 0096-09-EWC2/033 (vendim për ndalim disiplinor ndaj ADU);

Shtojca 15, një faqe, pa datë, nga 0096-09-EWC2/019 (fletëlëshimi për AZ në trajtim mjekësor nga data 30.11.2006 deri me datë 19.01.2007);

Shtojca 16, një faqe e datës 24.08.2009 nga 0096-09-EWC2/036 (Njoftimi i AZ nga Inspektoriati i Policisë së Kosovës lidhur me ankesën e tij);

Shtojca 17, një faqe e datës 11.05.2004 nga 0096-09-EWC2/020 (vertetim se AZ ka qenë pjesëtar i UCK-së);

Shtojca 18, një faqe e datës 02.06.2008 nga 0096-09-EWC2/021 (vertetim për AZ për shërbimet e tij në UCK);

Shtojca 19 (identifikime të ndryshme fotografike).

12) Deklarata e AZ përpara Prokurorit Special me datë 07 tetor 2010, me shtojca:
Identifikime të ndryshme fotografike.

39. Dosja B e PSRK-së e cila përmban:

- 1) Procesverbalin e dëgjimit të dëshmitarit Y në PSRK, PPS 09/10, datë 20 prill 2010;
- 2) Procesverbalin e dëgjimit të dëshmitarit anonim C në PSRK, PPS 07/10, datë 21 shtator 2010, me shtojca:
Shtojcë 1 (identifikime fotografike).
- 3) Deklarata e marrjes në pyetje e dëshmitarit anonim I nga policia e EULEX-it, PPS 07/10, datë 22 nëntor 2010, me shtojca:
Identifikime të ndryshme fotografike.
- 4) Procesverbalin e dëgjimit të dëshmitarit A në PSRK, PPS 07/10, datë 23 shtator 2010, me shtojca:
Shtojca 1, një faqe e datës 02.03.99 nga 0096-09-EWC2/022 (manual mbi implementimin e procedurës ndaj të burgosurve);
Shtojca 2, një faqe, skicë e burgut të Kleckës;
Shtojca 3, letër shoqëruese nga NJHKL, datë 09.06.2010, me identifikime fotografike;
Shtojca 5, një faqe e datës 15.05.99 nga 0096-09-EWC2/031 (kërkesë për deklaratë me shkrim mbi të drejtat dhe detyrat e personelit të burgut);

- Shtojca 5, një faqe e datës 17.05.1999 nga 0096-09-EWC2/025 (aktgjykimi për dëshmitarin anonim B);
- Shtojca 7, një faqe e datës 14.02.99 nga 0096-09-EËC2/023 (udhër nga gjyqtari ushtarak për pranimin e një të burgosuri);
- Shtojca 8, një faqe e datës 02.02.99 nga 0096-09-EWC2/034 (udhër nga gjyqtari ushtarak për pranimin e dy të burgosurve).
- 5) Deklarata e marrjes në pyetje e dëshmitarit anonim F nga policia e EULEX-it, PPS 07/10, datë 02 janar 2011, me shtojca:
Identifikime të ndryshme fotografike.
- 6) Procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit BKU në PSRK, PPS 07/10, datë 04 tetor 2010.
- 7) Procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit E në PSRK, PPS 07/10, datë 28 tetor 2010, me shtojca:
Shtojca 1, një faqe e datës 02.03.99 nga 0096-09-EWC2/022 (manual mbi implementimin e procedurës ndaj të burgosurve);
Shtojca 2, një faqe e datës 17.05.1999 nga 0096-09-EWC2/025 (aktgjykimi për dëshmitarin anonim B);
Shtojca 3, një faqe e datës 14.02.99 nga 0096-09-EWC2/023 (urdhër nga gjyqtari ushtarak për pranimin e një të burgosuri);
Shtojca 4, një faqe e datës 02.02.99 nga 0096-09-EWC2/034 (urdhër nga gjyqtari ushtarak për pranimin e dy të burgosurve).
- 8) Deklarata e marrjes në pyetje e dëshmitarit anonim B nga policia e EULEX-it, datë 04 dhjetor 2010, me shtojca:
Identifikime të ndryshme fotografike.
- 9) Deklarata e marrjes në pyetje e dëshmitarit G nga policia e EULEX-it, datë 11 janar 2011, me shtojca:
Identifikime të ndryshme fotografike.
- 10) Deklarata e marrjes në pyetje e dëshmitarit H nga policia e EULEX-it, datë 24 gusht 2010, me shtojca:
Identifikime të ndryshme fotografike.
40. Më tej Prokurori Special në përgjigjen e tij të datës 12 mars 2012, deklaroi se raportet e zvarrosjes, që gjenden në Dosjen I dhe Dosjen L, janë zbuluar mbrojtjes mes datës 11 maj 2011 dhe 07 korrik 2011. Duhet të konstatohet se seancat nga marrja në pyetje e AZ kanë filluar me datë 05 korrik 2011. Nga përgjigja e Prokurorit Special nuk është e qartë nëse raportet e zvarrosjes janë siguruar përpara datës 05 korrik 2011. Për këtë arsye, trupi gjykues nuk është në gjendje të arrijë në ndonjë përfundim lidhur me këtë.
41. Me datë 13 maj 2011 Prokuroria ka zbuluar mbrojtjes së FL dokumente të marra gjatë bastisjes së vendbanimit të FL në prill të vitit 2010. Gjatë paraqitjes së argumenteve në

shqyrtim kryesor, prokurori ka pranuar se lënda e tij nuk bazohet në asnjërin prej këtyre dokumenteve.

42. Me datë 09 korrik 2011, e cila ishte dita e katërt e ekzaminimit të AZ nga mbrojtja në korrik të vitit 2010, prokurori ka zbuluar kopje të ditarit të AZ 0096-09-EWC2/001,002, 011, 013 dhe 014. Trupi gjykues vëren se këto materiale nuk përfaqësojnë tërësinë e të ashtuquajturve 'ditare të luftës' në të cilët AZ mbështetet shumë gjatë dhënies së deklaratave të tij lidhur me ngjarjet gjatë konfliktit të vitit 1998-1999.²¹ Lidhur me këtë, duhet të konstatohet se këto janë zbuluar **pasi** që avokati mbrojtës kryesor i FL kishte përfunduar pyetjet e tij dhe ishte larguar nga Kosova. Për më tepër, mbrojtja pohon dhe Prokurori nuk mohon se përkthimi në gjuhën angleze i ditarit nuk është zbuluar mbrojtjes deri në janar të vitit 2012.
43. Prokurori bën edhe vërejtjet shtesë si në vijim:
- 1) Mbrojtja mund të kishte ardhur në çdo kohë në zyrën e Prokurorit Special për të parë dosjen e lëndës dhe se disa prej avokatëve mbrojtës e kanë bërë këtë por jo të gjithë.
 - 2) Në kohën e ekzaminimit të AZ nga mbrojtja në korrik 2011, prokurori në pajtim me KPPK-në nuk ishte i detyruar të zbulonte mbrojtjes materialet që ai kishte në posedim.
 - 3) Se nuk është kërkesë ligjore e KPPK-së, neni 156 (2) që mbrojtja të ketë në posedim gjithë materialin hetues në dosjen e lëndës në kohën e mundësisë për pyetje.
44. Pas konstatimit të çeshtjeve të zbulimit të diskutuara më lart, në vijim është lista e materialeve të cilët me sa duket nuk janë zbuluar mbrojtjes përpara datës 05 korrik 2011. Lista në vijim është përpiluar bazuar në dosjet e gjykatës me datë 21 mars 2012. Materialet lidhur me të cilët gjykata nuk ka qenë në gjendje të përcaktojë në mënyrë definitive nëse ato ishin në posedim të prokurorit para datës 5 korrik 2011 janë përfshirë në listë por janë shënuar me fusnotë në mënyrë të duhur.²²

²¹ Materialet të cilave u referohet si 'ditare luftime' përfshijnë dokumentet në vijim: 0096-09-EWC2/008, 009, 010, 011, 012, 013, 014, 015, 016. Siç u konstatua më lart, disa pjesë të dokumenteve të shënuara 0096-09-EWC2/009, 0096-09-EWC2/010, 0096-09-EWC2/015 dhe 0096-09-EWC2/016 nuk përmbajnë datë në vetvete lidhur me faktin se kur mund të jenë shkruar (p.sh. në krye të faqes siç ndodh në disa raste të tjera) por disa prej tyre u referohen datave dhe/apo ngjarjeve në vitin 1998, 1999 dhe janë kryesisht në të njëjtin format si të ashtuquajturit 'ditare luftime' (p.sh. copa letrash të ndara me emra të ndryshëm të shkruar). Për këtë arsye gjykata i ka konsideruar ato si pjesë të të ashtuquajturve 'ditare luftime'.

²² Gjykata konstaton se lidhur me disa prej Raportëve të Policisë me shtojca të ndryshme nuk ka vula apo fletëpranime të cilat do të mund të vertetonin kohën kur këto dokumente janë dorëzuar Prokurorisë. Megjithatë, në këto raste gjykata mbështetet në datat në letrat shoqëruese drejtuar Prokurorit në datën e përmendur apo pas pak kohe.

- 1) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit QK, 14.06.2011, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 2) Procesverbali i deklaratës së dëshmitares AQ, 07.06.2011, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 3) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit T, 03.05.2011, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 4) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit S, 14.06.2011, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 5) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit V, 18.04.2011, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 6) 1)Procesverbali i deklaratës së dëshmitares HBY, 08.04.2011, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 7) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit IA, 07.04.2011, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 8) Procesverbali i deklaratës së dëshmitares NAM, 06.04.2011, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 9) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit NM, 05.04.2011, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 10) Procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit BZ, 04.04.2011, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 11) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit DD, 04.04.2011, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 12) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit ZK, 04.04.2011, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 13) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit BEK, 08.01.2011, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 14) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit N, 04.01.2011, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 15) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit D, 18.01.2011, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 16) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit R, 22.12.2010, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 17) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit NH, 02.12.2010, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 18) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit AO, 30.11.2010, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 19) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit HK, 20.10.2010, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 20) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit BT, 08.10.2010, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 21) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit JU, 24.08.2010, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 22) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit GB, 14.06.2011, PPS 07/2010, PSRK Dosja C;
- 23) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit L, 12.04.2011, PPS/07, PSRK Dosja D;
- 24) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit M, 30.03.2011, PPS/07, PSRK Dosja D;
- 25) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit M, 20.05.2011, PPS/07, PSRK Dosja D;
- 26) Procesverbali i deklaratës së AH, 14.12.2010, PPS/07, PSRK Dosja D;
- 27) Procesverbali i deklaratës së AH, 27.05.2011, PPS/07, PSRK Dosja D;
- 28) Procesverbali i deklaratës së SB, 27.05.2011, PPS/07, PSRK Dosja D;
- 29) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit U, 26.06.2011, PPS/07, PSRK Dosja D;
- 30) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit W, 16.06.2011, PPS/07, PSRK Dosja D;
- 31) Procesverbali i deklaratës së IZ, 19.05.2011, PPS/07, PSRK Dosja D;

- 32) Procesverbali i deklaratës së BAZ, 23.05.2011, PPS/07, PSRK Dosja D;
- 33) Procesverbali i deklaratës së ST, 25.05.2011, PPS/07, PSRK Dosja D;
- 34) Procesverbali i deklaratës së RI, 24.05.2011, PPS/07, PSRK Dosja D;
- 35) Procesverbali i deklaratës së FK, 13.05.2011, PPS/07, PSRK Dosja D;
- 36) Procesverbali i deklaratës së ZS, 18.05.2011, PPS/07, PSRK Dosja D;
- 37) Procesverbali i deklaratës së VS, 17.05.2011, PPS/07, PSRK Dosja D;
- 38) Procesverbali i deklaratës së LS, 18.05.2011, PPS/07, PSRK Dosja D;
- 39) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit O, 24.05.2011, PPS/07, PSRK Dosja D;
- 40) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit Q, 26.05.2011, PPS/07, PSRK Dosja D;
- 41) Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit P, 25.05.2011, PPS/07, PSRK Dosja D;
- 42) Procesverbali i deklaratës së BET, 05.04.2011, PPS/07, PSRK Dosja D;
- 43) Dokumente të shënuara 0096-09-EWC/003, PPS/07, PSRK Dosja F;
- 44) Dokumente të shënuara 0096-09-EWC/004, PPS/07, PSRK Dosja F;
- 45) Dokumente të shënuara 0096-09-EWC/005, PPS/07, PSRK Dosja F;
- 46) Dokumente të shënuara 0096-09-EWC/006, PPS/07, PSRK Dosja F;
- 47) Dokumente të shënuara 0096-09-EWC/007, PPS/07, PSRK Dosja F;
- 48) Dokumente të shënuara 0096-09-EWC/008, PPS/07, PSRK Dosja F;
- 49) Dokumente të shënuara 0096-09-EWC/009, PPS/07, PSRK Dosja F;
- 50) Dokumente të shënuara 0096-09-EWC/010, PPS/07, PSRK Dosja F;
- 51) Pjesë dokumentesh të shënuar 0096-09-EWC/012 (faqe të shënuara 4, 5), PPS/07, PSRK Dosja F;
- 52) Dokumente të shënuara 0096-09-EWC/015, PPS/07, PSRK Dosja F;
- 53) Dokumente të shënuara 0096-09-EWC/016, PPS/07, PSRK Dosja F;
- 54) Dokumente të shënuara 0096-09-EWC/017, PPS/07, PSRK Dosja F;
- 55) Dokumente të shënuara 0096-09-EWC/018, PPS/07, PSRK Dosja F;
- 56) Ditar Përmbledhës dhe Hetues (pp. H2-H5), PPS/07, PSRK Dosja H;²³
- 57) Hetime Ante Mortem (pp. H6-H20), PPS/07, PSRK Dosja H;²⁴
- 58) Hetime Post Mortem (pp. H21-H40), PPS/07, PSRK Dosja H;²⁵
- 59) Përfshirja e Prokurorit (pp. H41-H46), PPS/07, PSRK Dosja H;²⁶
- 60) Prova (pp. H112-H134), PPS/07, PSRK Dosja H;²⁷
- 61) CD mbi Zhvarrosjen në Vendin e Varrezave KER, PPS/07, PSRK Dosja H;²⁸

²³ Bazuar në dokumentet që gjenden në Dosjen H nuk mund të përcaktohet koha kur Prokurori ka marrë në posedim këto dokumente.

²⁴ Bazuar në dokumentet që gjenden në Dosjen H nuk mund të përcaktohet koha kur Prokurori ka marrë në posedim këto dokumente.

²⁵ Bazuar në dokumentet që gjenden në Dosjen H nuk mund të përcaktohet koha kur Prokurori ka marrë në posedim këto dokumente.

²⁶ Bazuar në dokumentet që gjenden në Dosjen H nuk mund të përcaktohet koha kur Prokurori ka marrë në posedim këto dokumente.

²⁷ Bazuar në dokumentet që gjenden në Dosjen H nuk mund të përcaktohet koha kur Prokurori ka marrë në posedim këto dokumente.

- 62) Raport Paraprak i Policisë me Shtojca, përfshirë deklaratat e dhëna nga AZ policisë së EULEX-it të datës 20.11.2009, 30.11.2009 dhe 3.12.2009, PPS/07, PSRK Dosja M;
- 63) Raporti i Policisë mbi Ekspertizën e Sendeve të marra në Vendbanimin e NK, datë 20.6.2011, PPS/07, PSRK Dosja M;
- 64) Raporti i Policisë mbi Ekspertizën e Sendeve të marra në Vendbanimin e NK, datë 17.06.2011, PPS/07, PSRK Dosja M;
- 65) Raporti i Policisë mbi Bastisjen e NS me shtojca, datë 18.3.2011, PPS/07, PSRK Dosja M;
- 66) Raporti i Policisë mbi Ekspertizën e Sendeve të marra në Vendbanimin e NK dhe NS dhe CD-ja e bashkangjitur, datë 06.05.2011, PPS/07, PSRK Dosja M;
- 67) Raporti Përfundimtar i Forensikës mbi Ekspertizën e Sendeve të marra në Vendbanimin e NK dhe shtojca, pa datë, PPS/07, PSRK Dosja M;²⁹
- 68) Raporti i Policisë mbi Bastisjen në Spitalin e Prishtinës dhe Marrja e Dosjeve Mjekësore Origjinale të Dëshmitarit Bashkëpunues X me dosjen e bashkangjitur, datë 02.02.2011, PPS/07, PSRK Dosja M;
- 69) Dorëzimi i sendeve të marra në shtëpinë e NS, datë 07.06.2011, PSRK Dosja M;
- 70) Procesverbali i deklaratës së dhënë nga AZ në TPNJ (CD), KA nr. 505/11, KA Dosja 1;³⁰
- 71) Procesverbali i Intervistës së Ekspertit me Fotoalbum, datë 20.01.2010, KA nr. 505/11, KA Dosja 1;
- 72) Raportet e Autopsisë dhe shtojca të tjera, data të ndryshme para vitit 2011, KA nr. 505/11, KA Dosja 1;³¹
- 73) Raporte Autopsie të UNMIK-ut, datë 29.10.2009, KA nr. 505/11, KA Dosja 1;³²
- 74) Tabela Krahasuese Ante Mortem – Post Mortem, datë 2/4/2010, 2/5/2010, 12/7/2009, 12/9/2010, 12/7/2009, Dëshmi P28b deri P28f, GjPP 425/2011 Dëshmi të Prokurorit Dosja 1;³³
- 75) Raporte nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore DFM KEQ 01 and DFM KEQ 02, të dy mbajnë datën 10 dhe 11 gusht 2010, Dëshmi P29a dhe P29b, GjPP 425/2011 Dëshmi të Prokurorit Dosja 1.³⁴

e) Analizë e Rrethanave lidhur me Mundësinë për të Sfiduar AZ

44. Trupi gjykues vëren se gjatë shqyrtimit kryesor mbrojtja ka pretenduar se disa veprime do të duhej të ishin kryer nga Prokurori Special lidhur me marrjen në pyetje të AZ. Prokurori

²⁸ Bazuar në dokumentet që gjenden në Dosjen H nuk mund të përcaktohet koha kur Prokurori ka marrë në posedim këto dokumente.

²⁹ Nuk është përcaktuar koha kur Prokurori ka marrë këto dokumente në posedim.

³⁰ Nuk është e qartë koha kur Prokurori ka marrë CD-në në posedim.

³¹ Nuk është përcaktuar koha kur Prokurori ka marrë këto dokumente në posedim.

³² Nuk është përcaktuar koha kur Prokurori ka marrë këto dokumente në posedim.

³³ Nuk është përcaktuar koha kur Prokurori ka marrë këto dokumente në posedim.

³⁴ Nuk është përcaktuar koha kur Prokurori ka marrë këto dokumente në posedim.

Special është përgjigjur se KPPK-ja nuk parasheh ndonjë procedurë të qartë dhe për këtë arsye Prokurori Special nuk kishte detyrim. Prokurori Special ka qëndrim të ngjashëm në përgjigjen e tij të datës 12 mars 2012. Për shëmbull, në paragrafin C, Prokurori Special pohon se KPPK-ja nuk parasheh procedurë për revokimin e sekretit të deklaruar nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake për shtojcat B1 deri në B9 (bashkangjitur kërkesës së Prokurorit për të deklaruar AZ dëshmitar bashkëpunues, datë 05 korrik 2010). Për këtë arsye nuk ka ndonjë procedurë për të ndjekur.

45. Sipas këtij argumenti, nëse KPPK-ja përbën një udhërrëfyes në kuptimin se vetëm procedurat e parapara qartë mund të ndiqen, atëherë përveç Prokurorisë, edhe mbrojtjes duhet ti jepet e drejta e të njëjtit nivel sigurie ligjore dhe qartësie procedurale. Qëndron fakti se KPPK-ja, neni.1(1) parasheh parimin e përgjithshëm se Kodi 'përcakton rregullat e procedurës penale, **të detyrueshme** për procedurat në gjykatat e rregullta, për prokurorin dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë penale'.
46. Trupi Gjykues vlerëson se KPPK-ja, neni.156(2) nuk është procedurë në vetvete. Me fjalë të tjera, KPPK-ja nuk parasheh procedurë për Prokurorinë në fazën e hetimeve për të bërë ekzaminime të dëshmitarëve sipas nenit 156 (2) të KPPK-së. Neni.156(2) i KPPK-së është një rrjet sigurie. Me fjalë të tjera, në rastet kur ka ekzistuar mundësia për të marrë në pyetje një dëshmitar në një fazë të procedurës dhe pastaj ky dëshmitar nuk është më në dispozicion, neni 156 (2) i KPPK-së mund të shpëtojë dëshminë. KPPK-ja parasheh rrethana ku dëshmitarët mund të ekzaminohen nga i pandehuri apo avokati mbrojtës në fazën e hetimeve, për shëmbull neni 237(4) i KPPK-së.. Kjo nuk e ngrin nenin 156(2) të KPPK-së në nivel procedure të paraparë nga KPPK-ja për ti lejuar Prokurorit që të krijojë mbrojtjes mundësinë për të ekzaminuar një dëshmitar për të cilin Prokurori ka frikë se mund të mos jetë në dispozicion për tu ekzaminuar në Shqyrtim Kryesor.
47. Për më tepër, për aq sa neni156(2) i KPPK-së është një rrjet sigurie, kërkesat janë fleksibile për të përmbushur rrethanat e këtij rasti. Në një grabitje të thjeshtë në rrugë ku mund të jenë vetëm një apo dy dëshmitarë, hetimi është i thjeshtë dhe mundësia për të marrë në pyetje një dëshmitar shumë shpejt pas fillimit të hetimit është po aq e plotë sa në fund të hetimit. Mundësia e duhur dhe adekuate mund të realizohet lehtë. Në një rast të ndërlikuar ku dëshmitari është faktikisht edhe bashkëkryes, është i vetmi dëshmitar për sa u përket fakteve kyçe (me një mbështetje) dhe i vetmi dëshmitar për sa u përket identiteteve të bashkëkryesve të pretenduar (pa mbështetje) dhe në rast se ai më vonë ka vdekur, kërkesat për përmbushjen 'adequate dhe të duhur' të testit janë shumë më të mëdha dhe mund të kërkojnë deri në ekzaminimin e plotë nga pala tjetër siç do të ndodhte në shqyrtim kryesor.

48. Ajo që është e qartë nga çdo pikëpamje lidhur me faktet e kësaj lënde, është se ajo që ka ndodhur në ekzaminimin në muajin korrik 2011 ka qenë shumë larg nga një standart i tillë. Mbrojtjes nuk i janë siguruar të gjitha materialet e nevojshme për tu përgatitur në mënyrë adekuate dhe të duhur për marrë në pyetje dëshmitarin e vetëm inkriminues në këtë lëndë. Për këtë do të duheshin të gjitha deklaratat e dhëna nga dëshmitari për këtë çeshtje, përfshirë deklaratat e dhëna në TPNJ, deklaratat e dhëna policisë së EULEX-it (jo citime nga një dokument tjetër por origjinalin), Dosjen psikiatrike të AZ, dhe një vlerësim të saktë nga Prokuroria të materialve të tjera që ajo ka, të cilat kanë minuar lëndën e saj apo ndihmuar mbrojtjen. Është e rëndësishme se ditaret do të duhej të ishin zbuluar në tërësi. Gjatë ekzaminimeve të tij AZ në mënyrë të përsëritur ka thënë se atij nuk i kujtoheshin çeshtjet pa konsultuar ditarin e tij. AZ në seancën dëgjimore të datës 07 korrik 2011 është pyetur nga mbrojtja: 'Nëse për shembull ditari kishte humbur, cila do të ishte e vërteta?' AZ është përgjigjur: 'Në atë rast nuk do të kisha qenë në gjendje të tregoja historinë.'³⁵ Për më tepër, prokuroria, **në kohën e seancave dëgjimore të korrikut 2011**, ka qenë në posedim të 41 deklaratave të tjera të dëshmitarëve të tjerë por nuk ka pranuar ti vejë në dispozicion te mbrojtjes në mënyrë që marrja në pyetje e AZ të bëhet në kontekst të duhur lidhur me atë që kanë thënë dëshmitarë të tjerë.
49. Duhet gjithashtu të vihet në kontekst ajo që Prokurori i ka thënë mbrojtjes lidhur me qëllimin e seancave dëgjimore të korrikut 2011. Në seancën dëgjimore të datës 05 korrik 2011, e cila ishte seanca e parë dëgjimore e AZ nga mbrojtja, prokurori special ka deklaruar: 'kjo seancë është caktuar në mënyrë specifike për të ju dhënë mundësinë për të kundërshtuar deklaratat e dëshmitarit bashkëpunues AZ. Nëse ju e vlerësoni të nevojshme, mund ti bëni atij çdo lloj pyetje lidhur me hetimin aktual kundër klientëve tuaj.'³⁶ Këto vërejtje hyrëse nga Prokurori Special i kanë dhënë përshtypjen mbrojtjes se ata (mbrojtja) mund të bënin pyetje lidhur me **hetimin** ndaj të pandehurve nëse e vlerësonin të nevojshme. Më tej, gjatë seancës dëgjimore të datës 05 korrik 2011 Prokurori Special duke u përgjigjur kërkesës për zbulim të avokatit mbrojtës Karim A.A.Khan, jurist në MB, konstatoi se Prokuroria nuk ishte e detyruar të zbulojë dhe '**nuk e dimë nëse do të kemi shqyrtim kryesor**' dhe '**nëse do të kemi shqyrtim kryesor do të respektojmë afatin**'.³⁷ Në këtë kontekst, trupi gjykues konstaton gjithashtu përmbajtjen e nenit 7(2) të KPPK-së, i cili parasheh se Prokuroria 'duhet të vënë në dispozicion të mbrojtjes të gjitha faktet dhe provat të cilat janë në favor të të pandehurit përpara fillimit dhe gjatë procedurës'.

³⁵ Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit Bashkëpunues në Hetim në PSRK, PPS 07/10, datë 07 korrik 2011, fq.38, pyetje nr.511), PSRK Dosje A/bis

³⁶ Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit Bashkëpunues në Hetim në PSRK, PPS 07/10, datë 05 korrik 2011, fq.2, PSRK Dosja A/bis

³⁷ Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit Bashkëpunues në Hetim në PSRK, PPS 07/10, datë 05 korrik 2011, fq.3, PSRK Dosja A/bis

50. Në këtë mënyrë Prokurori ka marrë rol kryesisht pasiv duke deklaruar në mënyrë të përsëritur se ai thjesht po i jepte mbrojtjes një mundësi për të marrë në pyetje AZ **‘lidhur me hetimin aktual’**. Për më tepër, Prokurori Special ka deklaruar: ‘kjo është një mundësi për ju sot që unë po ju a jap. Nëse doni ta merrni këtë mundësi, mirë, nëse jo varet prej jush.’³⁸ Për më tepër, qëndrimi pasiv i Prokurorit bashkë me qëndrimin e prokurorit ndaj çështjeve të zbulimit të ngritura nga mbrojtja len të mendohet se prokurori nuk ka pasur konsideratë për materialet që ai kishte në posedim dhe nëse ndonjë nga këto materiale mund ti nevojitet mbrojtjes për të ndihmuar në përgatitjen dhe marrjen në pyetje në mënyrë të duhur të AZ, në veçanti duke pasur parasysh qëndrimin e tij të paraqitur në paragrafin 50 më lart se ai nuk ishte i detyruar të zbulojë.
51. Nga konteksti i seancave dëgjimore të korrikut të vitit 2011 mbrojtja ka mundur në mënyrë të arsyeshme të presë që kjo të mos jetë mundësia e vetme për të marrë në pyetje AZ. Prokurori Special duke iu përgjigjur avokatit mbrojtës Bajram Tmava lidhur me praninë e AZ në shqyrtimin kryesor thotë: ‘Nëse do të ketë shqyrtim kryesor ne do të ndjekim rregullat e procedurës.’³⁹ Për më tepër, Prokurori Special ka ftuar mbrojtjen të bëjë pyetje AZ lidhur me ‘hetimin aktual’.⁴⁰ Në këtë mënyrë, mbrojtja është udhëzuar që marrja në pyetje të mos shkojë përtej hetimit.
52. Siç është konstatuar më lart, Prokuroria bazon lëndën në AZ. Duke kuptuar se kërkesat e parapara nga neni 156(2) i KPPK-së janë fleksibile për të përmbushur nevojën e kompleksitetit të lëndës dhe rëndësinë e dëshmitarit, mund të jetë që për të përmbushur siç duhet nevojat e kësaj lënde, mundësia për të marrë në pyetje do të duhej të ketë pothuajse të njëjtin nivel domethënës sa marrja në pyetje nga mbrojtja në shqyrtim kryesor. Me fjalë të tjera, mbrojtja do të duhej të kishte kuptuar qartë se ekzistonte mundësia që kjo të ishte mundësia e vetme për të marrë në pyetje AZ dhe se për këtë arsye ishte e nevojshme që mbrojtja ti bënte atij të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me rastin sikurse të ishte marrje në pyetje në shqyrtim kryesor. Lidhur me këtë, trupi gjykues vëren se në disa rrethana GJEDNJ ka pranuar kufizime të mbrojtjes në marrjen në pyetje të një dëshmitari të prokurorisë. Këto kufizime kanë përfshirë refuzimin për të thirrur një dëshmitar në shqyrtim kryesor, duke i dhënë mbrojtjes një mundësi në fazën paraprake për të bërë pyetje një dëshmitari përmes një oficeri të policisë. Kjo ndodh shpesh në rastet kur një dëshmitar i tillë vlerësohet në kategorinë e dëshmitarëve të brishtë si për shembull, një fëmijë viktimë apo një viktimë e një krimi seksual ku legjislacioni vendor parasheh mundësinë e marrjes në pyetje nga mbrojtja jashtë gjykatës. Në rrethana të tilla,

³⁸ Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit Bashkëpunues në Hetim në PSRK, PPS 07/10, datë 05 korrik 2011, fq.3, PSRK Dosja A/bis

³⁹ Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit Bashkëpunues në Hetim në PSRK, PPS 07/10, datë 05 korrik 2011, fq.3, PSRK Dosja A/bis

⁴⁰ Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit Bashkëpunues në Hetim në PSRK, PPS 07/10, datë 05 korrik 2011, fq.2, PSRK Dosja A/bis

mbrojtja është plotësisht e vetëdijshme se kjo mund të jetë mundësia e vetme për të marrë në pyetje dëshmitarin dhe për këtë arsye atyre u kërkohet të kenë një qasje të punës së tyre mbi këtë bazë. Dështimi për të vepruar në këtë mënyrë nuk lejon mbrojtjen që të kundërshtojë këtë provë në shqyrtim kryesor.⁴¹

53. Duke pasur parasysh praktikën e lartpërmendur, rrethanat e kësaj lënde nuk i kanë mundësuar mbrojtjes që të kuptojë pa mëdyshje se kjo mund të ishte mundësia e vetme për të bërë një marrje në pyetje të plotë të AZ. Përkundrazi, Prokurori Special ka konstatuar se mund të bëhen pyetje lidhur me ‘hetimin aktual’ dhe se Prokurori Special nuk ishte i sigurtë nëse do të kishte shqyrtim kryesor dhe nëse ka shqyrtim kryesor do të ndiqeshin rregullat e procedurës.⁴² Për më tepër, në dy raste Prokurori Special ka deklaruar mbrojtjes në terma të qartë: ‘Mos mi tregoni letrat.’⁴³ ‘Jam i kënaqur se ju po paraqisni të gjitha kundërshtimet që mund të ngrisni në shqyrtimin kryesor. Por ky nuk është qëllimi i kësaj seance dëgjimore. A dëshironi me të vërtetë të hapni letrat?’⁴⁴
54. Për rrjedhojë, ka ekzistuar një indikacion pozitiv nga Prokuroria se do të kishte mundësi tjetër për të kundërshtuar dëshmitarin kryesor. Trupi gjykues pranon se KPPK-ja nuk parasheh ndonjë kusht për Prokurorinë që të informojë mbrojtjen se kjo mund të jetë mundësia e saj e vetme për të marrë në pyetje një dëshmitar. Megjithatë, trupi gjykues nuk mund të vlerësojë se ekzistonte ndonjë arsye tjetër për të justifikuar seancat dëgjimore të korrikut të vitit 2011 përveç se, shqetësimi i prokurorit ishte ruajtja e provave ndaj rrezikut se AZ mund të mos ishte në dispozicion në shqyrtimin kryesor. Prokurori ishte në një pozitë ku kishte shumë përparësi në krahasim me mbrojtjen për të bërë një vlerësim të tillë, dhe nëse ky ishte vlerësimi i tij, konceptet bazike të drejtësisë kërkojnë që mbrojtja do të duhej të ishte informuar për këtë aty për aty. Në veçanti duke pasur parasysh se mbrojtja përmendi për procesverbal se ajo do të kishte një qasje të kufizuar në parashtrimin e pyetjeve ne seancat e korrikut të vitit 2011 (shih paragrafin. 32 sipër). Fakti se KPPK-ja nuk parasheh zbulimin mbrojtjes në atë fazë të procedurës nuk

⁴¹ *Shih për shembull S.N. v. Sweden*, Aktgjykim i datës 2 korrik 2002, GJEDNJ, paragrafë.47, 48, 49, 50, 52, 53, <http://cmiskp.echr.coe.int/tkp197/view.asp?item=1&portal=hbkm&action=html&highlight=S.N.&sessionId=88782809&skin=hudoc-en>. GJEDNJ kur është gjetur përballë deklaratës së një dëshmitari kyç, gjithashtu i bashkë-akuzuar, e marrë gjatë hetimit, **ka bërë vërejtje lidhur me faktin nëse procedura e ballafaqimit në fazën paraprake ka qenë një zëvendësim i duhur i ekzaminimit të të bashkë-akuzuarit në seancë të hapur në gjykatë.** *Shih Melnikov v. Russia*, Aktgjykim i datës 14 janar 2010, ECtHR, paragrafë.75, 76, 78, 80, 81, <http://cmiskp.echr.coe.int/tkp197/view.asp?item=1&portal=hbkm&action=html&highlight=Melnikov&sessionId=89045413&skin=hudoc-en>

⁴² Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit Bashkëpunues në Hetim në PSRK, PPS 07/10, datë 05 korrik 2011, faqet.2, 3, PSRK Dosja A/bis

⁴³ Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit Bashkëpunues në Hetim në PSRK, PPS 07/10, datë 05 korrik 2011, fq.4, PSRK Dosja A/bis

⁴⁴ Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit Bashkëpunues në Hetim në PSRK, PPS 07/10, datë 05 korrik 2011, fq.5, PSRK Dosja A/bis

ndihmon Prokurorinë sepse Kodi nuk ka paraparë një procedurë të tillë të cilën Prokuroria ka pretenduar se ka realizuar. Në fakt, Prokuroria ka shpikur një procedurë e cila nuk është paraparë në Kod.

55. Provat më bindëse në mbështetje të mendimit të trupit gjykues të shprehur më lart burojnë nga neni 238 i KPPK-së i cili parasheh Mundësi Hetuese të Jashtëzakonshme. Neni 238 i KPPK-së e bën plotësisht të qartë se ligjvënësit gjatë përpilimit të KPPK-së nuk kanë paraparë rrethana të jashtëzakonshme 'me qëllim të ruajtjes së provave në rastet kur ekziston... një rrezik serioz se këto prova mund të mos jenë pastaj në dispozicion në shqyrtim kryesor'.
56. Duhet të merret parasysh motivi i Prokurorisë kur ajo kërkon të bëjë ekzaminimin e AZ në korrik të vitit 2011. Siç u konstatua më lart, duhet të jetë që Prokuroria të paktën ka marrë parasysh mundësinë se ekzistonte një rrezik serioz që AZ mund të mos ishte në dispozicion në shqyrtimin kryesor dhe për këtë arsye Prokuroria kërkonte të ruante provat e tij në bazë të rrjetit të sigurisë nga neni 156(2) i KPPK-së.
57. Trupi gjykues arrin në përfundimin se Prokuroria kishte këtë ide sepse përndryshe nuk ka arsye të spjegueshme për të kërkuar mbajtjen e seancave në korrik të vitit 2011. Kjo është në veçanti kështu sepse AZ në kohën e ekzaminimeve ishte dëshmitar i mbrojtur, ai kishte qenë i tillë më parë por kishte dalur nga Programi i mbrojtjes së dëshmitarëve dhe gatishmëria e tij për të dëshmuar dhe/apo bashkëpunuar me Prokurorinë kishte qenë e ndryshueshme. Për më tepër, Prokurori Special në kërkesën e tij për lëshimin e një urdhër arresti, datë 28 shkurt 2011, kishte thënë: 'Në veçanti përsa i përket dëshmitarit bashkëpunues X, ka prova të bollshme... se të paktën prej vitit 2003 ndaj tij është ushtruar presion në të gjitha format, frikësim, kërcënim dhe sulm fizik, përfshirë të paktën dy tentativa vrasjeje ...' Prokurori Special ka pohuar gjithashtu: '... ka shumë mundësi që të pandehurit, personalisht apo përmes të të dërguarve të tyre do të përpiqen dhe do të eliminojnë dëshmitarin bashkëpunues X sepse ai përbën burimin kryesor të informacionit dhe provave kundër tyre.'⁴⁵ Gjithashtu, Gjyqtari i Procedurës Paraprake në vendimin me anë të të cilit urdhëroheshin masa paraprake, datë 17 mars 2011, ka pranuar vlerësimet e Prokurorit Special dhe ka konstatuar: '... ka pak dyshime përsa i përket aftësisë së të pandehurve për të kryer krime të një dhune ekstreme dhe gjithashtu, më në veçanti, lidhur me sjelljen e tyre të dhunshme ndaj dëshmitarit X. Është shumë e mundur që pasi që ata të vijnë në dijeni të hetimit penal aktual kjo sjellje do të përforcohet.'⁴⁶
58. Në rrethana të tilla, është plotësisht e arsyeshme që Prokuroria të kërkojë të ruaj dëshminë e tij nga rreziku që në të ardhmen AZ të tërhiqej nga bashkëpunimi dhe nga

⁴⁵ Kërkesë e PSRK-së për Lëshimin e një Urdhër Arresti, PPS 07/2010, datë 28 shkurt 2011, Gjykata GjPP Dosja 2

⁴⁶ Vendim për Caktimin e Masave Paraprake, PPS 07/2010, GjPP 25/2010, datë 17 Mars 2011, Gjykata GjPP Dosja 2

mungesa e mundësisë së vënies në dispozicion për Shqyrtim Kryesor. Neni 238 i KPPK-së merret saktësisht me këtë skenar. Por përmban mbrojtje kyçe që ngrehin Nenin 238 të KPPK-së në pozitën e një procedure të sanksionuar me KPPK e jo në atë të rrjetit mbrojtës, Neni 156(2) të KPPK-së. Neni 238(2) kërkon që procesi të ndodhë para gjykatësit të procedurës paraprake i cili është i obliguar të 'merr masat e nevojshme për të siguruar efikasitetin dhe tërësinë e procedurës dhe në veçanti **për të mbrojtur të drejtat e të pandehurit**'. Dhe, marrja e dëshmisë duhet të bëhet në pajtim me Kapitujt XX, XXI dhe XXII të Kodit. Me fjalë tjera, kjo procedurë do t'i ngjante goxha njëloj njëfarë procesi të Shqyrtimit Kryesor. Mbrojtja do ta kishte mundësinë të kërkojë zbulimet për të cilat kanë nevojë. Gjykatësi i Procedurës Paraprake do ta kishte mundësinë të siguroj që zbulimi i duhur është bërë në kohë të mirë dhe se Mbrojtjes i është dhënë kohë për përgatitje sa duhet (jo tetë ditë që faktikisht janë dhënë) dhe se Mbrojtja do ta vlerësonte në tërësi se kjo ka mund të jetë një dhe e vetmja mundësi për t'i bërë pyetje dëshmitarit. Prokuroria do të ishte e para ta merr në pyetje dëshmitarin. Mbrojtja do të vepronte njëjtë. Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të ishte në gjendje të vlerësoj sjelljen, besueshmërinë dhe kredibilitetin e dëshmitarit dhe provat që rrjedhin do të ishin të një standardi shumë më të lartë dhe më të sigurt se sa çfarë në të vërtetë është krijuar.

59. Në parashtrimet me shkrim Prokurori argumenton se ekzistenca e një mekanizmi alternativ për të siguruar dëshmitë e AZ nuk ka vlefshmëri mbi procedurën e ndjekur. Për arsyet që tashmë u dhanë, Neni 156(2) i KPPK-së nuk përbën një procedurë dhe nuk është një mekanizëm alternativ në vete. Pra ky argument i Prokurorisë dështon. Përpos kësaj Prokuroria argumenton se kërkesat juridike për të vënë në funksion Nenin 238 të KPPK-së nuk janë përmbushur. Kjo është thjeshtë e gabuar pasi nuk ekziston ndonjë shpjegim tjetër i mundshëm për Prokurorin të vazhdoj ashtu siç bëri por nga frika reale dhe substanciale që AZ mund të mos jetë në dispozicion për Shqyrtim Kryesor apo mbase të jetë në dispozicion porse kanë hequr dorë nga dëshmia e tij e mëparshme.
60. Për më tepër, interpretimi nga Prokuroria i Nenit 156(2) të KPPK si nen përbën një procedurë alternative nga ajo e Nenit 238 të KPPK që do të shkonte në kundërshtim me parimet e përgjithshme të Procedurës Penale të Kosovës. Neni 8(2) i KPPK parasheh 'gjykata shpall vendimin e vet në bazë të **provave të ekzaminuara dhe të verifikuara në shqyrtim kryesor**'. Si e tillë KPPK-ja vë në theks parimin e menjëherëshmërisë. Kjo detyron që dëgjimi i të gjitha provave relevante lidhur me akuzat të dërgohen menjëherë para trupit gjykues në mënyrë të atillë që t'i mundësohet trupit gjykues të dëgjoj dëshmitë e të akuzuarve dhe të dëshmitarëve drejtpërdrejtë që është më mirë se sa të njeh ato përmes leximit të shënimeve të shkruara. Si rrjedhojë, përjashtimi nga ky parim duhet të merret me shumë kujdes.

61. Përmes krahasimit, ashtu siç duket, disa sisteme juridike shtetërore nuk vejnë theks të fortë në dëshminë gojore. Megjithatë, kodet përkatëse parashohin ndjekjen e procedurës me marrjen e deklaratës së dëshmitarit. Në procedurën penale Holandeze rrallë ndodhë që dëshmitarët të paraqiten në gjykatë. Në vend të kësaj ata marrin pjesë (së paku në lëndë të rënda) në ballafaqime paraprake, në përgjithësi para gjykatësit hetues dhe mbrojtjes, dhe dëshmitë e tyre regjistrohen dhe dorëzohen në gjykatë në formë të dosjes së shkruar. Në disa Kantone Zvicerane, përfshi Cyrihun, një lloj Prokurori (*Bezirksanwalt*) është përgjegjës për organizimin e ballafaqimit paraprak në mes të akuzuarit dhe të dëshmitarëve. Këto pastaj regjistrohen në dosje dhe i parashtrohen gjykatës.⁴⁷
62. Derisa Neni 8 i KPPK-së parasheh që provat, si rregull i përgjithshëm, të dëgjohen në Shqyrtim Kryesor, atëherë Neni 238 i KPPK parasheh përjashtim nga ky rregull i përgjithshëm. Po ashtu duhet rikujtuar se Neni 238(2) kërkon në veçanti që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të merr masa të tilla aq sa është e nevojshme për të 'mbrojtur të drejtat e mbrojtjes'. Në këtë aspekt rrjeti i sigurisë në kuptim të Nenit 156(2) të KPPK duhet të merret me kujdes shumë të madh në vlerësimin në qoftë se masat e marra mund të bashkërendohen me ushtrimin e efektshëm dhe të duhur të të drejtave të mbrojtjes.
63. Trupi Gjykues konsideron se duke marrë parasysh rrethanat e kësaj lënde, marrja në pyetje sipas Nenit 156(2) të KPPK nuk është dashur të ndodhë fare, por është dashur të mbahet një mundësi hetuese e jashtëzakonshme sipas Nenit 238 të KPPK nën mbikëqyrjen e Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Për aq sa ekzaminimi ka ndodhë në pajtim me Nenin 156(2) të KPPK në rrethana tërësisht të jashtëzakonshme të kësaj lënde, Trupi Gjykues nuk konsideron se ajo çfarë ka ndodhë përbën një 'mundësi adekuate dhe të duhur' për të sfiduar AZ. Prandaj kushti precedent i Nenit 156(2) nuk është plotësuar.
64. Si rrjedhojë Neni 156(2) i KPPK vepron si pengesë e plotë ndaj dëshmisë së AZ e cila prandaj është e papranueshme në tërësi duke përfshirë të gjitha deklaratat e tij dhe ditarët e tij.

D. STATUSI I DËSHMITARIT BASHKËPUNUES KUNDREJT STATUSIT TË TË PANDEHURIT SA I PËRKET PËRMBAJTJES SË DEKLARATAVE

65. Seancat e intervistimit nga 4 shkurt 2010 deri më 20 gusht 2010 bënë që Prokurori Special të vendosë të ushtrojë te Gjyqtari i Procedurës Paraprake kërkesën që AZ të shpallet dëshmitar bashkëpunues. Në përgjigjen e tij me shkrim lidhur me argumentet për pranueshmëri, datuar 12 mars 2012, nën paragrafin E ('argumenti 2 i mbrojtjes'),

⁴⁷ Referuar në S. Summers, Gjykime të Drejta (Publikim nga Hart, Oxford dhe Portland, Oregon, 2007) faqet 135, 136.

prokurori sqaron se kërkesa për të shpallur një person dëshmitar bashkëpunues nuk mund të ushtrohet pa 'e bërë atë të dyshuar/të pandehur... duke filluar hetimin kundër tij'.

66. Trupi Gjykses nuk e pranon këtë propozim. Neni 298, KPPK përcakton se kush mund të jetë dëshmitar bashkëpunues. Neni 298, KPPK përcakton se 'shprehja 'dëshmitar bashkëpunues' do të thotë i dyshuar apo i pandehur ndaj të cilit aktakuza akoma nuk është lexuar në shqyrtim kryesor dhe i cili pritet të japë dëshmi në gjykatë', që përcakton ndonjë prej kërkesave të nën paragrafëve 1) deri në 5). Neni 151(1), KPPK përcakton 'të dyshuarin' si 'person ndaj të cilit policia apo autoritetet e prokurorisë kanë dyshim të arsyeshëm se ka kryer vepër penale, por ndaj të cilit procedura penale akoma nuk është nisur'. Ndërsa neni i njëjtë përcakton 'të pandehurin' si 'personin ndaj të cilit kryhet procedura penale'.
67. Neni 298, KPPK e bën të qartë se ose 'i dyshuari' ose 'i pandehuri' mund të shpallet dëshmitar bashkëpunues. Prandaj, nuk ka qenë domosdoshmërisht parakusht që të nisej hetimi kundër AZ para se të bëhej kërkesa që të shpallej ky i fundit dëshmitar bashkëpunues ngase prokuroria tashmë kishte informata të mjaftueshme për të shpallur AZ 'të dyshuar' siç përcaktohet me nenin 151 (1), KPPK. Ndonëse, mbase do të kishte qenë gjë e matur që së pari prokurori të intervistojë AZ për të vlerësuar kredibilitetin/besueshmërinë e tij. Ka qenë e mundur që kjo të bëhet në cilësinë e dëshmitarit /të dyshuarit në mënyrën e njëjtë siç ka folur policia me të.
68. Trupi Gjykses po ashtu vë re se pavarësisht nga merita e vendimit për të nisur hetimin ndaj AZ, me të bërë një gjë të tillë, prokurori e pa të nevojshme ta intervistojë 'për të verifikuar se a i konfirmon ai deklaratat e tij të mëparshme në cilësinë e tij të re si i pandehur'.⁴⁸ Mirëpo, pas ndërrimit të dytë të statusit, nga i pandehuri në dëshmitar bashkëpunues, prokurori nuk e pa të nevojshme që në atë fazë të verifikojë se a i konfirmon AZ deklaratat e tij të mëparshme në cilësinë e re prej dëshmitari bashkëpunues. Kjo është potencialisht e rëndësishme ngase paralajmërimet e bëra të pandehurit para se ky të japë deklaratë ndryshojnë në mënyrë thelbësore dhe domethënëse nga paralajmërimet që i bëhen një dëshmitari (përfshirë këtu edhe dëshmitarin bashkëpunues) para se ky i fundit të jep deklaratë.
69. Sa i përket ndërrimit të statusit nga i pandehur në dëshmitar bashkëpunues, prokurori special vë re se KPPK-ja nuk përmban asnjë dispozitë që kërkon prokurorin sërish të marrë në pyetje të dyshuarin/të pandehurin pasi që ky i fundit të fitojë status të ri. Trupi Gjykses vë re se njëlloj, KPPK-ja nuk përmban asnjë dispozitë që kërkon prokurorin të

⁴⁸ Shih parashtresat me shkrim të prokurorisë, nëntitulli (e) përgjigje ndaj argumentit 2 të mbrojtjes, faqe 4 nga 11

përsërisë/konfirmojë deklaratat e mëparshme si rezultat i ndërrimit të statusit nga dëshmitar në të pandehur. Megjithatë, është e qartë se prokurori besoi se është e nevojshme/e matur që të veprohet kështu në këtë rast.

70. Duke ditur dallimet materiale në dhënien e paralajmërimeve një të dyshuari/të pandehuri dhe një dëshmitari, së paku do të kishte qenë e arsyeshme që pas ndryshimit të statusit nga i pandehur në dëshmitarë bashkëpunues të ri-intervistoj AZ e ta pyes: së pari, t'i rilexojë deklaratat e tij të mëparshme; e dyta, të konfirmojë duke marrë parasysht paralajmërimin dhe obligimin e dëshmitarit se deklaratat që ai ka dhënë si i pandehur janë të vërteta; dhe së fundi, nëse duhet të bëjë ndonjë ndryshim apo korrigjim. Me këtë AZ do t'i jepej një mundësi e qartë të miratojë atë çfarë ka thënë më herët si i pandehur në cilësinë e tij të re si dëshmitarë.
71. Prokurori pohon se 's'ka nevojë të thuhet se të gjitha deklaratat e mëparshme të paraqitura nga personi ato bëhen të dëshmitarit bashkëpunues'. Trupi Gjykes nuk pajtohet me këtë. Përkundrazi, paralajmërimi lidhur me **obligimin për të thënë të vërtetën** që i jepet një dëshmitari është i detyrueshëm dhe i panegociushëm.⁴⁹ Ky paralajmërim nuk i është dhënë gjatë asnjë nga intervistat e AZ kur ai ka patur statusin e të pandehurit dhe duke mos e ftuar AZ të miratojë ato deklarata të mëparshme në cilësinë e tij si dëshmitar nënkupton se një hap esencial verifikimi nuk është ndërmarrë. Kjo nuk mund të arrihet retrospektivisht pas vdekjes së AZ. Prokurori kërkon të ndreq këtë mungesë duke pohuar se gjatë seancës për dëshmitar bashkëpunues AZ është paralajmëruar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake se duhet të thotë të vërtetën dhe kur ai është pyetur nëse ai konfirmon të gjitha deklaratat e tij të mëparshme si vërteta, ai e bën këtë.⁵⁰ Trupi Gjykes nuk është në gjendje të pranojë këtë argument si korrigjim të mangësisë. Sa i përket seancës mbi dëshmitarin bashkëpunues, Neni 300(1) i KPPK parasheh që 'deklarimet e bëra para gjyqtarit gjatë këtij ekzaminimi nuk mund të përdoren në procedurë penale kundër...ndonjë personi si prova që mbështesin zbulimin e fajësisë'. Argumenti i Prokurorisë që mbështetet në atë çfarë AZ ka thënë në seancë për përcaktimin e statusit të tij të dëshmitarit bashkëpunues shkon plotësisht në kundërshtim me ndalimin nga Neni 300(1) i KPPK. Prokuroria e ka të ndaluar të mbështetet në atë çfarë i ka thënë AZ Gjykatësit të Procedurës Paraprake në përpjekje për të treguar saktësinë e deklaratave të tij të mëparshme të dhëna si i pandehur në mënyrë që t'i përdorë ato deklarata drejtpërdrejtë në përkrahje të gjetjes së fajësisë për të pandehurit. KPPK-ja e ndalon këtë kurs qartë.

⁴⁹ Neni 164(2) i KPPK thotë: ' Dëshmitarit së pari i tërhiqet vërejtja se detyrohet të flasë të vërtetën dhe se nuk guxon të heshtë asgjë, e pastaj i bëhet me dije se dhënia e dëshmisë së rremë është vepër penale '

⁵⁰ Përgjigje e Prokurorisë ndaj Argumenteve të Mbrojtjes mbi Pranueshmërinë e Deklaratave të AZ, me 12 mars 2012, faqe 4, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor 8

72. Për këto arsye, dhe veç arsyeve të dhëna nën Titullin C më lartë në këtë aktvendim, deklaratat e AZ nga 04 shkurt deri me 20 shkurt 2010 të cilat janë dhënë si i pandehur dhe jo si dëshmitar dhe prandaj pa paralajmërim të detyrueshëm të dëshmitarit janë të papranueshme.

E. Deklaratat B1 deri B9

73. Mbrojtja po ashtu sulmon pranueshmërinë e deklaratave të AZ të datave nga 04 shkurt deri me 09 qershor 2010 mbi baza tjera. Këto deklarata i janë bashkëngjitur kërkesës së Prokurorit Special për të shpallur AZ dëshmitar bashkëpunues, të datës 05 korrik 2010, shënuar B1 dhe B9. Me 19 gusht 2010, në pajtim me Nenin 299(2) të KPPK, Prokurori dorëzon një kërkesë te Gjykatësi i Procedurës Paraprake për urdhër për mbajtjen sekret të pretendimeve faktike të bëra në kërkesën për të shpallë AZ dëshmitar bashkëpunues , përkatësisht shtojcat B1 deri te B9. Me 25 gusht 2010 Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshon një urdhër duke shpallë AZ dëshmitar bashkëpunues dhe për më tepër urdhëron që 'pretendimet faktike të bashkëngjitura në kërkesë për të shpallë AZ dëshmitarë bashkëpunues (shtojca B1 deri te B9 e kërkesës së Prokurorit ta shpallë dëshmitar bashkëpunues) të mbyllen dhe të mbesin sekret nga palët tjera dhe avokatëve të tyre mbrojtës '.

74. Mbrojtja argumenton *inter alia* se arsyeja e Nenit 300(i) të KPPK është që me këtë të përjashtohen deklaratat B1 deri te B9 nga lënda pasi ato përbëjnë 'deklarata të dhëna gjykatësit gjatë kësaj marrje në pyetje' (p.sh. seanca për dëshmitar bashkëpunues). Trupi Gjykues refuzon këtë propozim duke qenë se është shumë i gjerë në interpretim. B1 deri te B9 nuk mund të shihen si deklarata të dhëna gjykatësit gjatë marrjes në pyetje.

75. Megjithatë, kjo nuk adreson veprimet e Prokurorit sa i përket urdhrit për fshehtësi. Qëllimi i qartë i urdhrit ishte ruajtja e integritetit të hetimit që ishte duke u zhvilluar. Megjithatë, urdhri nuk ishte i kufizuar me afate kohore apo me kufizime të funksionit. Prokurori mendon se Neni 299(3) i KPPK 'qartas i referohet thjeshtë një hapi procedural me të cilin pretendimet faktike...do të mbahen fshehtë për qëllimin e kufizuar të procedurës për dëshmitar bashkëpunues' me fjalë tjera, e kufizuar vetëm për atë qëllim. Kërkesa e Prokurorit dhe urdhri i Gjykatësit kanë mundur të jenë aq të kufizuara, dhe asgjë nuk e ka ndaluar Prokurorin për të kërkuar urdhër për fshehtësi të kufizuar për një funksion specifik apo për një kohë specifike. Por ai nuk e bën këtë, dhe urdhri vijues i Gjykatësit të Procedurës Paraprake ishte në dukje një imponim absolut i fshehtësisë.

76. Prokurori Special mendon se nuk ekziston procedurë në KPPK për revokimin e fshehtësisë. Procedura e dëshmitarit bashkëpunues sipas KPPK-së është qartë brenda kompetencave

të Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe jo Prokurorit. Thjeshtë nuk është e hapur për Prokurorin të zgjedhë se si të interpretohet urdhri i Gjykatësi të Procedurës Paraprake dhe kur njëanshëm të sjellë ndikimin e urdhrit në përfundim. Asgjë në KPPK nuk e parandalonte Prokurorin të kthehej te Gjykatësi i Procedurës Paraprake në fazën e duhur , për shembull, me një kërkesë për urdhër për arrestim me kërkesë për heqjen e urdhrit për fshehtësi e që deri atëherë do ta përmbushte funksionin e tij.

77. Megjithëse vet, kjo veçori nuk do të arsyetonte përshtetimin e deklaratave të papranueshme, ajo çfarë fillon të shfaqet është një sërë gabimesh nga Prokuroria të cilat kanë ndikim të tillë kumulativ nga të cilat integriteti i hetimit dhe procesi i shqyrtimit kryesor nuk mund të mbrohen. Ai ndikim kumulativ i bën deklaratat të papranueshme.

F. NËNSHKRIMI DHE PËRKTHIMI I DEKLARATAVE TË AZ

78. Trupi Gjykues paraqet argumentin e njëjtë sa i përket ankesës së Mbrojtjes në atë që deklaratat e AZ nuk janë nënshkruar kurrë siç duhet. Neni 89(2) i KPPK thotë: 'Procesverbalin e nënshkruan personi i cili merret në pyetje. Kur procesverbali përbëhet nga më shumë se një faqe, personi i pyetur nënshkruan secilën faqe.' Kjo nuk është një ftesë negociimi në Kod. Është udhëzim i detyrueshëm. Qëllimi i tij është i qartë. Është për të siguruar pronësinë e përmbajtjes së procesverbalit nga personi i pyetur. Siguron që të mos ndërhyhet në të, të mos ndryshohet dhe të mos rrezikohet në ndonjë mënyrë në një fazë më të vonshme. Trupi Gjykues nuk sugjeron në asnjë mënyrë që Prokuroria të ketë ndryshuar deklaratat e AZ, sepse nuk ka prova të tilla. Megjithatë, duke ekzaminuar deklaratat e dhëna në Polici të EULEX-it dhe te Prokurori, është e dukshme që ato nuk janë nënshkruar në secilën faqe nga AZ por vetëm në fund.
79. Për sa i përket deklaratave të AZ të dhëna në cilësinë e të pandehurit me 04, 09, 11, 16, 17 shkurt 2010, 10, 16, 25 mars 2010, 20 gusht 2010, nuk janë nënshkruar në secilën faqe nga AZ. Ashtu siç është konfirmuar nga Prokurori Special gjatë rrjedhës së shqyrtimit kryesor dhe nga përgjigjja me shkrim e Prokurorit e datës 12 mars 2012, Prokurori vet kishte vënë inicialet e tij në secilën faqe të disa deklaratave të AZ. Siç është parë më herët Neni 89(2) i KPPK kërkon që 'personi i pyetur nënshkruan secilën faqe'. Prokurori Special në përgjigjen e tij me shkrim të datës 12 mars 2012 pohon se: 'Mungesa e nënshkrimit të tij (AZ) në secilën faqe nuk konsiston qartë me papranueshmëri.' Trupi Gjykues refuzon këtë argument. Përkundrazi Neni 231(4) i KPPK për sa i përket marrjes në pyetje të të pandehurit saktë kërkon që procesverbali me shkrim të bëhet në pajtim me Nenin 89 të KPPK *inter alia* (nëse regjistrimi video apo audio i marrjes në pyetje nuk është i mundur). Më tutje, Neni 156(1) thotë: 'Deklarimi i të pandehurit i dhënë...prokurorit publik mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë **vetëm** kur është marrë në pajtim me dispozitat e

nenit 229 deri në 236' dhe neni 231(4) përfshin kërkesën sipas nenit 89 të KPPK që dëshmitari të nënshkruaj secilën faqe.

80. Tjetër, Trupi Gjykes konstaton lëshimin nga Prokuroria gjatë argumentimit në Gjykatë se AZ në asnjë fazë nuk i janë dhënë kopje të deklaratave të tij në Shqip për të lexuar dhe për të kontrolluar ai vet. Në vend të kësaj, Prokurori pohon se përkthyesi ka lexuar përmbajtjet e deklaratës deri atëherë kur AZ e ka kuptuar atë. Me respekt, ky është një vlerësim i bërë nga Prokurori për të përcaktuar nëse dikush tjetër ka kuptuar siç duhet atë çfarë i është përkthyer dhe lexuar AZ. Personi i vetëm i cili mund dhe duhet të bëj këtë duhet të jetë vet AZ duke ia dhënë një kopje të deklaratë së tij në Shqip për ta lexuar, kuptuar dhe korrigjuar nëse është e nevojshme, dhe për ta nënshkruar secilën faqe në fund e që vërteton pronësinë e përmbajtjes nga ai. Si pasojë mosrespektimi i nenit 89 të KPPK i bën deklaratat të papranueshme në Gjykatë, veçanërisht kur konsiderohen së bashku me ndikimin kumulativ me shkeljet tjera të Kodit tashmë të identifikuar në këtë aktvendim.
81. Mbrojtja po ashtu argumenton se dy nga deklaratat e nënshkruara nga AZ ato të 09 qershorit 2010 dhe 20 gusht 2010 respektivisht duhet të jenë papranueshme sepse në atë fazë ai ka qenë i pandehur dhe prapë ka nënshkruar si dëshmitar. Trupi Gjykes e refuzon këtë argument. Paralajmërimet që i janë dhënë atij në fillim të seancës dëgjimore janë ato që janë të përshtatshme për të pandehurin. Për këtë arsye as AZ dhe asnjëri prej të pandehurve apo avokat mbrojtës në shqyrtimin kryesor nuk kanë mundur të jenë keq orientuar nga diçka që nuk është gjë tjetër përveç se një gabim i parëndësishëm.

G. PRANUESHMËRIA E DEKLARATAVE TË DHËNA POLICISË PARA AKTVENDNIMIT MBI FILLIMIN E HETIMEVE

82. Mbrojtja argumenton se deklaratat e dhëna nga AZ në Polici të EULEX-it para aktvendimit mbi fillimin e hetimeve duhet të shpallen të papranueshme sepse ato thjeshtë janë dhënë para atij aktvendimi. Ky argument refuzohet nga Trupi Gjykes. Nuk mund të lëshohet Aktvendim mbi fillimin e hetimeve përveç dhe deri sa policia të ketë kryer hetimet paraprake për të përcaktuar nëse ka arsye të bazuar apo jo për të besuar se një vepër penale është kryer dhe kush është kryerësi. Neni 200 dhe 201 i KPPK autorizon policinë të veprojnë ashtu siç vepruan, dhe Neni 156(1) i KPPK thotë qartas se deklaratat e dhëna në polici mund të jenë të prova pranueshme në gjykatë (varësisht nga respektimi i rregullave tjera). Edhe pse ky argument i Mbrojtjes refuzohet është e qartë për arsyet e cekura më lartë, provat e kontestuara mbesin të papranueshme.

H. MOSPRANIA E AVOKATIT MBROJTËS

83. Mbrojtja mbron pikëpamjen se gjatë gjithë kohës kur AZ ishte i dyshuar, ishte e detyrueshme që ai të përfaqësohej nga një avokat. Ky argument bazohet në dy elementë. Së pari, KPPK, Neni 73(1)5 kërkon praninë e avokatit mbrojtës kur i akuzuari pranon fajësinë. Së dyti, KPPK, Neni.73(1)1) kërkon praninë e avokatit mbrojtës kur i akuzuari shfaq shenja çrregullimi mendor.
84. Të trajtojmë së pari pikën mbi pranimin e fajësisë. Është e qartë se KPPK, Neni 73(1)5 parasheh praninë e avokatit mbrojtës si të detyrueshme kur i pandehuri kërkon që të lidhë marrëveshje **për t' u deklaruar fajtor**. Kjo është baza e procedurës së pranimin të fajësisë. AZ nuk ka hyrë në një marrëveshje të tillë. Për këtë arsye prania e avokatit mbrojtës nuk ka qenë e detyrueshme. Mbrojtja pretendon se Prokuroria në një farë mënyre ka gabuar duke informuar AZ se ky i fundit mund të hiqte dorë avokati mbrojtës sepse KPPK-ja nuk parasheh që i pandehuri të informohet lidhur me një të drejtë të tillë. Kjo pikë është e pakuptimtë dhe informimi i të pandehurit se ai mund të mos marrë avokat mbrojtës nëse dëshiron kështu nuk shkakton asnjë dëm i mundshëm.
85. Për sa i përket çështjes së shëndetit mendor, trupi gjykues pranon se bazuar në faktet e lëndës, dihej se AZ kishte një të kaluar psikiatrike. Mund të jetë që Prokuroria të ketë qenë më e kujdesshme për të marrë një vlerësim psikiatrik të freskët përpara fillimit të intervistave të AZ në vitin 2010, një qëllim i rëndësishëm i kësaj duke qenë neutralizimi i një pike potenciale të mbrojtjes. Megjithatë, neni 73(1)1) i KPPK-së bën praninë e avokatit mbrojtës të detyrueshme vetëm nëse 'nga ekzaminimi i parë, kur i pandehuri ... **shfaq shenja çrregullimi mendor apo paaftësi** dhe për këtë arsye ai është i paaftë të mbrohet vetë në mënyrë efektive'. Nuk ka prova se AZ kishte shfaqur shenja të tilla në kohën e intervistave në vitin 2010 pavarësisht nga gjendja e tij në vitet e mëparshme. Përkundrazi, ai është dukur të jetë i qartë dhe racional në tregimin që ka dhënë. Mbrojtja i referohet pranisë së Psikologut nga Njësia për Mbrojtjen e Dëshmitarëve si provë e sëmundjes psikiatrike. Kjo është e pasaktë. Është e qartë se Psikologu është ekspert tjetër nga Psikiatri dhe roli i Psikologëve nga Njësia për Mbrojtjen e Dëshmitarëve është i kufizuar në sigurimin e gjendjes shëndetësore të një personi për të qenë në Programin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve. Megjithatë, mund të pohohet në të njëjtën mënyrë se ka pak gjasa që Psikologu të mos ketë qenë aktiv sikurse AZ të kishte shfaqur ndonjë shenjë çrregullimi mendor.
86. Trupi gjykues gjen se ky argument i mbrojtjes nuk qëndron.

I. DËSHIMI PËR TË INFORMUAR AZ SE DËSHMIA E TIJ MUND TË PËRDORET NË GJYKATË

87. Siç konstatohet në paragrafin 16 më lartë, Prokuroria nuk ka informuar AZ në fillim të intervistimit të tij në vitin 2010 se ajo çfarë ai ka thënë mund të përdoret si provë para gjyqit. Kjo padyshim është shkelje e dispozitës detyruese të nenit 231(2)5) të KPPK. Megjithatë është e qartë se qëllimi i menduar i kësaj dispozite është mbrojtja e të pandehurit nga fjalët e tij të përdorën kundër tij në shqyrtim kryesor, së paku, për të siguruar se ai është në dijeni se ato mund të përdoren. Me fjalë tjera funksioni i kësaj dispozite është të ruaj deklaruesin dhe jo të tjerët. Është po ashtu e qartë mbi faktet e kësaj lënde se AZ ishte në dijeni të plotë se fjalët e tij do të përdoren në gjykatë. Në të vërtetë ishte shpresa e tij se ato do të përdoren. Pra, ndonëse ekziston shkelje e Kodit, nuk është asi shkelje që do të arsyetonte shpalljen e deklaratave pasuese të papranueshme. Kjo gjetje është e pavarur nga gjetjet e lartpërmendura të Trupit Gjykses lidhur me papranueshmërinë e deklaratave të viti 2010 në baza të ndryshme.

J. ÇËSHTJE TJERA TË NDRYSHME

88. Mbrojtja ngre dy argumente shtesë dhe/ose parime. Ata ankohen se Prokurori ka dështuar të siguroj prova të grafologjisë pavarësisht kërkesave të përsëritura për sigurimin e tyre dhe ata mbështeten në parimin e *in dubio pro reo*. Duke patur parasysht gjetjet më lartë, nuk është e domosdoshme që Trupi Gjykses të adresojë asnjë nga këto çështje në mënyrë që të lëshojë aktvendim e tij mbi pranueshmërinë

89. Për t'iu shmangur dyshimit, Trupi Gjykses gjen të gjitha deklaratat e dhëna nga AZ në këtë lëndë të papranueshme, për arsye të ndryshme të cekura më lartë. Sa i përket statusit të ditarëve, ndonëse ato mund të ndodh të merren parasysht si prova dokumentare, realiteti është se ato nuk mund të ekzistojnë të pavarura nga AZ. Ai thuhet të jetë autori i vetëm i tyre, ndonëse Mbrojtja e konteston këtë. Ditarët tani paraqesin dëshmi të dhëna jo nën betim dhe të paprovuara nga varri. Pasi që Mbrojtja nuk ka patur mundësi adekuate dhe të duhur të merr në pyetje AZ ashtu siç kërkohet *de minimis* për të shpallë dëshmitë e tij të pranueshme, rrjedhë se ditarët po ashtu janë të papranueshëm.

GJYQTAR KRYESUES:

Gjyqtari i EULEX-it Jonathan Welford-Carroll

ANËTARË TË TRUPIT GJYKYES:

Gjyqtare Shqipe Qerimi

Gjyqtari i EULEX-it Dean Pineles